

21 Gusht,2007

NGA: Sekretari Korporativ në Detyrë

**Plani i Zbatimit për Forcimin e Angazhimit të Bankës Botërore në Qeverisje dhe Anti-korrupsion**

**Rishikuar**

1. Bashkëngjitur është një dokument i titulluar “Plani i Zbatimit për Forcimin e Angazhimit të Bankës Botërore në Qeverisje dhe Anti-korrupsion”. Dokumenti është rishikuar për të marrë parasysh një draft më të hershëm të diskutuar nga CODE në takimin e organizuar në 30 Korrik 2007 (CODE2007-0063).
2. Siç u diskutua në takimin e CODE, ky version do të përdoret për një dialog të fokusuar publik mbi Planin e propozuar të Zbatimit. Në përfundim të këtij dialogu, Menaxhimi i Bankës Botërore do të ridorëzojë një Plan Zbatimi të rishikuar për një diskutim me Drejtorët Ekzekutivë, të caktuar paraprakisht për 1 Tetor 2007.
3. Pyetjet mbi dokumentet mund t’i referohen Z. Harrold (ext. 36048) ose Z. Pradhan (ext. 89 187).

Dërguar:

Drejtorëve Ekzekutivë

Presidentit

Drejtuesve të Lartë të Grupit të Bankës

Zëvendës Presidentëve, Bankë, IFC dhe MIGA

Drejtorëve dhe Shefave të Departamenteve, Bankë, IFC dhe MIGA

**PLANI I ZBATIMIT PËR FORCIMIN  
E ANGAZHIMIT TË BANKËS BOTËRORE  
NË QEVERISJE DHE ANTI-KORRUPSION**

**JO FINAL  
PËR QËLLIME TË DIALOGUT TË FOKUSUAR PUBLIK**

*Shërbimet e Vendeve dhe Politikave Operative*

*17 Gusht 2007*

## SHKURTIME DHE AKRONIME

AAA	Aktivite Analitike dhe Këshillimore
AML	Kundër pastrimit të parave
AUSAID	Agjencia Australiane për Zhvillim Ndërkombëtar
BP	Procedura e Bankës
CAS	Strategjia e Asistencës për Vendin
CDD	Community-driven development
CFAA	Vlerësimi i Përgjegjshmërisë Financiare të Vendit
CFT	Lufta kundër financimit të terrorizmit
CPAR	Raporti i Vlerësimit të Prokurimeve të Vendit
CPIA	Vlerësimi i Politikës dhe Institucional i Vendit
cso	Organizatë e shoqërisë civile
DFID	Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar (Mbretëria e Bashkuar)
DPO	Operacioni i politikës së zhvillimit
EITI	Iniciativa e Transparencës së Industrive Nxjerrëse
FATF	Task Force i Veprimit Financiar
FLEG	Zbatimi i Ligjit dhe Qeverisja e Pyjeve, iniciativat rajonal Ministeriale
FSAP	Programi për Vlerësimin e Sektorit Financiar
GAC	Strategjia e qeverisjes
HIPC	Vend i varfër me borxhe të larta
HR	Burimet Njerëzore
IBRD	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
IDA	Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim
IEG	Grupi i Pavarur i Vlerësimit
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
IFI	Institucion financiar ndërkombëtar
IMF	Fondi Monetary Ndërkombëtar
INT	Departamenti Integritetit Institucional
ISN	Interim Strategy Note
MDB	Bankë shumëpalëshe e zhvillimit
MDG	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
MIGA	Agjenci Shumëpalëshe e Garantimit të Investimeve
NEPAD	Partneriteti i Ri për Zhvillimin e Afrikës
NGO	Organizatë jo-qeveritare
NVP	Zëvendës President i Rrjetit
OAS	Organizata e Shteteve Amerikane
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OECD-DAC	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim–Komiteti i Asistencës për Zhvillim
OED	Departamenti i Vlerësimit të Operacioneve
PACI	Iniciativa e Partneritetit Kundër Korrupsionit
PBA	Alokimi me bazë performancën (sistem)
PEFA	Përgjegjshmëria e Shpenzimeve dhe Financiare Publike
PER	Rishikim i Shpenzimeve Publike
PFM	Menaxhim Financiar Publik
PRSP	Dokumenti i Strategjisë për Uljen e Varfërisë
QAG	Grupi i Sigurimit të Cilësisë

QER	Rishikimi i Përmirësimit të Cilësisë
RVP	Zëvendës President Rajonal
SSIU	Azhornim i Zbatimit të Strategjisë së Sektorit
TA	Asistencë Teknike
UN	KOmbet e Bashkuara
UNECA	Komisioni Ekonomik për Afrikën e Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VDP	Program i Publikimit Vullnetar
VPU	Njësia Zëvendës Presidenciale
WBI	Instituti i Bankës Botërore
ËDR	Raporti i Zhvillimit Botëror

**PLANI I ZBATIMIT**  
**PËR FORCIMIN E ANGAZHIMIT TË BANKËS BOTËRORE**  
**NË QEVERISJE DHE ANTI-KORRUPSION**

<b>I.</b>	<b>Hyrje.....</b>	<b>1</b>
<b>II.</b>	<b>Ç'formë do të kishte Zbatimi i Suksesshëm i GAC? .....</b>	<b>1</b>
<b>III.</b>	<b>Tre Levels of Action .....</b>	<b>2</b>
	A. Nivel Vendi.....	2
	B. Nivel Projekti.....	4
	C. Nivel Global.....	6
<b>IV.</b>	<b>Stafi dhe Buxheti: Menaxhimi i Ndryshimit dhe Udhëheqja .....</b>	<b>7</b>
<b>V.</b>	<b>Vlerësimi, Koha, Rezultatet dhe hapat e Tjerë.....</b>	<b>9</b>
<b>VI.</b>	<b>Rreziqet.....</b>	<b>10</b>
<b>VII.</b>	<b>Kuadri i Veprimeve dhe Rezultateve të Qeverisjes dhe Anti-korrupsionit.....</b>	<b>12</b>

**Kutitë**

<b>Kutia 1.</b>	Politikat, Procedurat dhe Udhëzimet e Bankës: Përshtatje për të Pasqyruar Nevojat e GAC dhe të Klientëve .....	5
<b>Kutia 2.</b>	Cilët faktorë mund të pengojnë Impaktin e Planit të Zbatimit të GAC? .....	11

**Shtojcat**

<b>Shtojca A .</b>	Indikatorët e Qeverisjes dhe Përdorimi i Tyre.....	17
<b>Shtojca B .</b>	Raport i Drejtorëve Ekzekutivë Forcimi i Angazhimit të Grupit të Bankës Botërore në Qeverisje dhe Anti-Korrupsion.....	21

# PLANI I ZBATIMIT PËR FORCIMIN E ANGAZHIMIT TË BANKËS BOTËRORE NË QEVERISJE DHE ANTI-KORRUPSION

## I. Hyrje

1. Bordi i Drejtorëve miratoi unanimisht strategjinë e qeverisjes së Grupit të Bankës Botërore në Mars 2007. Ky plan zbatimi parashtron hapa konkretë për zbatimin e kësaj strategjie. Detajet e veprimeve të propozuara and rezultatet a tyre janë dhënë në matricën e bashkëngjitur. Gjithashtu, për lehtësi referimi, është bashkëngjitur dhe Raporti i Drejtorëve Ekzekutivë për Komitetin e Zhvillimit mbi Forcimin e Angazhimit të Bankës Botërore në Qeverisje dhe Anti-korrupsion i datës 28 Mars 2007 (DC2007-0005).
2. Plani është bazuar fuqimisht mbi shtatë parimet e GAC: GAC është bazuar mbi mandatin e Bankës për të trajtuar uljen e varfërisë, nuk është qëllim në vetvete; duhet të drejtohet nga vendi; duhet t'i përshatet rrethanave të vendit – dhe jo “një prerje për të gjithë”; kërkon që Banka të angazhohet që “të varfërit të mos paguajnë dy herë”; Banka do të punojë me shumë grupe interesi; nuk do të veprojë në mënyrë të izoluar, por në bashkëpunim me partnerë; dhe do të punojë për të forcuar, jo anashkaluar, sistemet e vendit nëpërmjet institucioneve më të forta.
3. Strategjia e GAC paraqiti themelet për një fokus më të thelluar të Grupit të Bankës Botërore mbi çështjet GAC dhe përshkroi në përgjithësi llojet e veprimtarive që mund të mbështesin dhe forcojnë rezultatet e e GAC në nivel vendi. Prandaj plani i zbatimit (IP) nuk do t'i riparaqesë këto çështje. Ky plan më tepër fokusohet mbi atë që do të bëjë vetë Grupi i Bankës Botërore për të mbështetur axhendën e GAC dhe se si do të punojë me qeveritë, grupet vendase të interesit, dhe partnerët e zhvillimit për të mbështetur përmirësimet në qeverisje në nivel vendi dhe iniciativat rajonale dhe globale.

## II. Ç'FORMË DO TË KISHTE ZBATIMI I SUKSESSHËM I GAC?

4. Në qendër të strategjisë së GAC është krijimi i një vizioni të përbashkët në të cilin vendet njohin lidhjet ndërmjet qeverisjes, korrupsionit, rritjes dhe reduktimit të varfërisë, dhe ku qeveritë po marrin hapa aktivë për të adresuar barrierat e qeverisjes ndaj një rritje më të shpejtë dhe përfshirëse dhe dhënie më të mirë shërbimesh, dhe në këtë mënyrë dhe ndaj uljes së varfërisë. Vizioni i suksesit në zbatimin e GAC do të ishte kur pengesat e qeverisjes ndaj zhvillimit të qëndrueshëm reduktohen në mënyrë që të varfërit të kenë akses në shërbime dhe mundësitë e rritjes. Që të ndodhë kjo, ne parashikojmë që:
  - a) një numër domethënës dhe në rritje i vendeve do të adresonte seriozisht pengesat kryesore që kanë në qeverisje, të cilat prekin efektivitetin e zhvillimit dhe në këtë mënyrë dhe uljen e varfërisë, dhe që bashkëpunojnë aktivisht me Bankën në këtë fushë;
  - b) programet dhe projektet e partnerëve tanë të mbështetura nga Banka do të adresonin gjithnjë e më shumë këto pengesa të GAC në një mënyrë sistematike; dhe
  - c) vendet dhe partnerët globalë vlerësojnë dhe respektojnë kapacitetin e Bankës në këtë fushë.

Iniciativat sipas IP të synuara për të përmirësuar politikën e vendit dhe qeverisjen institucionale dhe në këtë mënyrë uljen e varfërisë, duhet që, me kalimin e kohës, të pasqyrohen qartësisht në përmirësime në performancën e matshme të qeverisjes.

### III. TRE NIVELE VEPRIMI

5. Në ndjekje të strategjisë së GAC, plani i zbatimit së pari përshkruan veprimet e Grupit të Bankës Botërore në tre nivele kryesore – vendi, projekti dhe global. Pastaj ai qartëson veprimet e brendshme korrisponduese që janë të nevojshme për të mbështetur zbatimin e GAC, fokusuar mbi stafin, buxhetin dhe menaxhimin e ndryshimit. Ky plan bazohet në një histori të gjatë pune në këtë fushë në Bankë, veçanërisht në 10 vitet e fundit, dhe fokusohet mbi thellimin dhe përmirësimin, jo ri-shpikjen.<sup>1</sup> Paraqet atë që duhet të shikohet si një menu veprimtarish, jo një listë udhëzimesh, me formën dhe natyrën e angazhimit të Bankës në çdo vend të përcaktohet nga ekipet dhe drejtuesit e vendit, dhe nga iniciativat Rajonale dhe të Rrjetit. Kështu, ndërsa madhësia e menisë mund të duket ambicioze, ajo pasqyron faktin që vende të ndryshme do të zgjedhin aspekte të ndryshme mbi të cilat të përqëndrojnë përpjekjet e tyre, dhe prioritetet do të dalin jo si një ushtrim i centralizuar prioritizimi por si një rezultat i një procesi të intensifikuar dialogu ndërmjet partnerëve dhe ekipeve të vendit gjatë vitit të ardhshëm.
6. Ky plan ka si synim të fillojë zbatimin e axhendës së GAC. Fokusi i tij është përqëndruar më shumë mbi veprimet e menjëhershme të Grupit të Bankës Botërore mund të kërkojë rreth 12 muajt pasardhës—veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga ekipet e vendit, mbi ndryshimet në sistemet dhe proceset e Bankës, dhe mbi kërkesat për burimet e nevojshme për të mbështetur një process intensive të “mesimit-në-praktikë”. Gjatë shpalesjes së këtij procesi të mesimit-në-praktikë, sfidat dhe veprimet afat-mesme do të bëhen më të qarta – dhe do të detajohen në një raport të progresit të zbatimit, i cili do të përgatitet pas vitit të parë.

#### A. Niveli Vendor

7. Në zemër të planit të zbatimit duhet të jenë strategjitë vendore të cilat adresojnë efektivisht dhe sistematikisht pengesat e GAC ndaj zhvillimit dhe uljes së varfërisë. Dialogu me qeverinë dhe grupet e interesit rreth asaj se si çështjet e GAC çënojnë zhvillimin mund të përmirësohet në mënyrë të ndjeshme, dhe ekipet vendore mund të përdorin çdo mundësi—Përgatitja e Strategjisë së Asistencës për Vendin (CAS), zgjedhja e projekteve, përgatitja dhe zbatimi, vizita zyrtare të nivelit të lartë, aktivitete analitike dhe këshillimore (AAA), përfshirja sistematike me aktorët e interesit nga qeveria, biznesi dhe shoqëria civile, dialogu mbi politikën, dhe Grupet Konsultative—për të thalluar mirëkuptimin ndërmjet vendeve dhe Bankës mbi atë që mund të bëhet për të mbështetur përmirësimet në GAC si pjesë e strategjisë së përgjithshme të qeverisë për zhvillim, dhe për të thelluar mbështetjen e Bankës. Kështu, zbatimi kërkon që ekipet vendore të Grupit të Bankës Botërore të adresojnë dy grupe të ndara sfidash: (a) përfshirja më e mirë e dimensioneve të zhvillimit të GAC në CAS, dhe (b) zbatimi i CAS-eve në mënyrë që ndërhyrjet e GAC të mbështesin një efektivitet më të madh zhvillimi.
8. Shumë ekipe vendore kanë bërë vetëm këtë, kanë mbështetur klientët që të punojnë rreth mënyrave të rritjes së efektivitetit të zhvillimit dhe dhënies së shërbimeve si pjesë e strategjive vendore të uljes së varfërisë dhe Dokumentet e Strategjisë për Uljen e Varfërisë (PRPS). Kjo përfshin dhënien e mbështetjes për të ngritur institucione transparente dhe efektive dhe përfshirjen e veprimtarive të përmirësimit të qeverisjes në nivel projekti. Planit i zbatimit

---

<sup>1</sup> Dokumenti i plotë, *Forcimi i Angazhimit të Grupit të Bankës Botërore mbi Qeverisjen e Anti-korrupsionit (DC2007-0005)*, përmbledhja e të cilit është bashkëngjitur ai Shtojca B, përshkruan historinë e angazhimit të Bankës për qeverisjen dhe jep shumë shembuj.

parashikon mënyra për të thelluar, sistematizuar dhe përfshijnë këto qasje në një grup më të madh vendesh, në përgjigje të kërkesave të tyre.

9. Ky process në nivel vendor i propozuar për të forcuar angazhimin e Grupit të Bankës Botërore në qeverisje dhe anti-korrupsion—që ne do ta etiketojmë shkurt si CGAC—do të informojë CAS në një mënyrë themelore, bazuar në konsiderimin e disa elementeve:<sup>2</sup>
  - a) Përparimi i njohurive të rëndësishme të çështjeve të GAC që ekziston në vend dhe në Bankë, duke identifikuar dhe kuptuar pengesat kritike të qeverisjes dhe korrupsioni ndaj zhvillimit të vendit dhe synimeve të uljes së varfërisë;
  - b) puna me qeverinë partnerë të tjerë për një strategji të zbatueshme për të adresuar këto pengesa ndaj GAC, duke identifikuar pika fillimi dhe fusha angazhimi të mundshme, ose mënyra për të thelluar këtë angazhim në shumë vende ku Banka po bashkëpunon tashme me shumë sukses për të mbështetur sfida thelbësore dhe sektoriale të qeverisjes;;
  - c) përpunimi i mjeteve dhe instrumenteve nëpërmjet të cilave Grupi i Bankës Botërore mund të ndihmojë qeverinë të përmirësojë reformat e GAC dhe të adresojë pengesat kritike ndaj zhvillimit;
  - d) vlerësimi më sistematik i mënyrës se si qeverisja dhe korrupsioni prekin projektet dhe portofolin e Bankës, dhe zhvillimi i strategjive për të zbutur këto rreziqe; dhe
  - e) sigurimi që ekipi vendor ka kapacitetin organizativ dhe burimet për të dhënë efektivisht kontributin e Grupit të Bankës Botërore në strategjinë e përmirësuar të nivelit vendor, mbi bazën e lidhjes së zhvillimit të GAC.
10. Konsultimet e strategjisë së GAC treguan që shumë vende duan të trajtojnë këto çështje në mënyrë më sistematike, dhe do të mirëprisnin një përfshirje më të thellë të Grupit të Bankës Botërore. Për këto vende, CAS do të shtjellonte këtë partneritet të shtuar, siç kanë bërë disa nga CAS të fundit.<sup>3</sup> Për vendet e tjera ku çështjet e GAC gjykohen që janë një pengesë serioze ndaj uljes së varfërisë, por ku klienti nuk është akoma gati të trajtojë këto çështje apo të ketë mbështetjen e Bankës në këto fusha, në ruajtje të parimit të mbajtjes së angazhimit, CAS do të përshkruante pikat fillestare potenciale, do të kërkonte mënyra krijuese për të dhënë mbështetje (për shembull duke përdorur instrumente si zhvillimi i nxitur nga komuniteti apo sisteme të palëve të treta, në mënyrë që “të varfërit të mos paguajnë dy herë”), dhe/ose do të propozonte aktivitete AAA të hartuara për të rritur ndërjegjësimin mbi impaktin e çështjeve të GAC.
11. Këto procese CGAC të ekipit vendor do të informonin në rritje CAS-et e Grupit të Bankës Botërore, të cilët do të pritëshin të pasqyronin trajtimin sistematik të pengesave të GAC ndaj efektivitetit të zhvillimit: si do të mbështeste Grupi i Bankës Botërore reformën e GAC në vend për të përmirësuar zhvillimin dhe uljen e varfërisë dhe për të rritur efektivitetin e zhvillimit të politikës publike dhe shpenzimeve publike të vendeve, si dhe të programeve të mbështetura nga Banka. Në FY08, pritet që një pjesë e rëndësishme e CAS-eve – për një ndërthurje të vendeve përtej Rajoneve dhe me situatë të ndryshme qeverisjeje – do të marrin informacion nga ky evidentim dhe angazhim në çështjet e GAC, apo procesit të CGAC, dhe që cilësia e trajtimit të çështjeve GAC në CAS do të tregonte një përmirësim e shënuar. Disa ekipe vendore mund

<sup>2</sup> Vini re që plani i zbatimit të GAC nuk trajton çështjen se si do të alokohen burimet e IDA. Kjo pyetje ka marrë përgjigje përfundimtare në dokumentin e Bordit të vitit 2007, i cili pohoi se alokimi me bazë performancën (PBA) përbën bazën për alokimin e IDA. Në mënyrë të ngjashme, ky proces CGAC nuk prek sistemin e Vlerësimit të Politikës dhe Institucional të Vëndit (CPIA) që përforcon PBA, por duhet të lejojë më shumë përcaktim sistematik të komponentëve të qeverisjes të CPIA.

<sup>3</sup> Shembujt përfshijnë Shqipërinë, Bangladeshin, Hondurasin, Indonezinë dhe Raportin e Progresit të CAS të Kenias.

edhe të fillojnë procesin në një pikë të ndërmjetme gjatë ciklit të CAS, duke ju përgjigjur aktivisht [ikave hyrëse që shfaqen. Pas një përvojë një-vjeçare dhe vlerësimit të rezultateve të deriatëhershme, do të përcaktohet se si mund të kanalizohen këto procese GAC.

12. Siç u vu në dukje, këto përpjekje për të forcuar politikën dhe qeverisjen institucionale të vendeve duhet që, me kalimin e kohës, të pasqyrohen në përmirësime në performancë të matur të qeverisjes. Prandaj, një pjesë kritike e planit të zbatimit do të ishte matja më e mirë e qeverisjes, veçanërisht nëpërmjet treguesve më veprues, në zona ku është bërë tashmë një progress i mirë (siç është menaxhimi i financave publike), por dhe në sektorë të tjerë gjithnjë e më shumë, ku qeverisja më e mirë duhet të pasqyrohet në dhënie më të mirë shërbimesh. Është gjithashtu e rëndësishme të vazhdohet të përpunohen ato mjete që ekzistojnë tashmë në këtë fushë, dhe të mbahet parasysh që qeverisja është shumë-dimensionale, që tregues të ndryshëm kapin aspekte të ndryshme të qeverisjes, dhe që treguesi i duhur për tu përdorur baret nga qëllimi (shih Shtojcën A, “Treguesit e Qeverisjes dhe Përdorimi i Tyre”).
13. Për vitin e parë, plani i zbatimit kryesisht tregon rezultatet e procesit të brendshëm të Grupit të Bankës Botërore, të cilët janë të nevojshëm për të gjeneruar rezultatet e qeverisjes që synohen. Me kalimin e kohës, këto duhet të evoluojnë gradualisht në rezultate që pasqyrojnë më plotësisht ndryshimet në terren (për shembull, rezultatet e qeverisjes të pasqyruar në CAS-et e reja të ndërtuara në bazë të CGAC; masat në nivel projekti për përmirësimin e dhënies së shërbimeve; treguesit e qeverisjes më të mirë thelbësorë në zona siç janë reforma gjyqësore dhe menaxhimi financiar public; dhe përmirësimet cilësore të dala nga vëmendja e rritur ndaj çështjeve të kërkuesve).

## **B. Niveli i Projektit**

14. Në nivel sektori dhe projekti, theksi do të vihet mbi identifikimin integrimin e mundësive për përmirësimin e efektivitetit të zhvillimit nëpërmjet veprimeve të lidhura me GAC. Kjo kërkon theksimin e stimuljeve të përshtatshëm dhe mekanizmave të llogaridhënies të nevojshëm në nivel projekti dhe sektori për të bërë realitet qeverisjen e mirë sektoriale. Në thelb, kjo kërkon gjithashtu zhvillimin e sistemeve të forta fiduciare vendore të transparencës dhe llogaridhënies. Nëpërmjet zhvillimit të këtyre sistemeve vendore, dhe reduktimit të mundësive për korrupsion duke thjeshtëzuar rregullore dhe procedurën miratimi të tepërta dhe duke ndikuar mbi iniciativat e kërkuesve (përfshirë përmirësimin e aksesit në informacion dhe zhvillimin e mekanizmave mbikqyrës komunitarë dhe të palëve të treta), mund të gjendet mundësia më e madhe për një parandalim efektiv. Puna e kohëve të fundit në sektorët e transportit, arsimit dhe shëndetit tregon potencialin e këtyre qasjeve. Ndërtimi i institucioneve mund të luajë një rol kritik, veçanërisht për sistemet e prokurimit, raportimit dhe auditimit financiar, dhe llogaridhënies, në të cilat Banka ka regjistruar tashmë sukses dhe ka një pozicion të mirë për të mbështetur çuarjen më tej të dëshirave të vendit. Gjatë zbatimit, këto elemente të ndërtimit të institucioneve, reformës rregullatore dhe sektoriale, dhe kadri i stimuljeve që reduktojnë mundësitë për korrupsion do të shihen në një numër në rritje projektsh.
15. Janë filluar dhe do të thellohen proceset për të siguruar një analizë sistematike të çështjeve të GAC në punën në sektor, programeve sektoriale, dhe projekteve. (Kutia 1 nënvizon rishikimin në proces të politikës dhe procedurave të Bankës për të pasqyruar qasjet e praktikave të mira të GAC). Kyçi është të identifikohen në një fazë të hershme aty ku janë të pranishme rreziqet e GAC dhe kush janë shtytësit, dhe të fokusohen përpjekjet lehtësuese mbi këtë grup aktivitetesh. Kjo mund të përfshijë: (a) mbështetje për zbatim më të mirë të buxhetit të nivel sektori, (b)

përmirësim i kapacitetit dhe stimujve të ministrive të linjës për të ndërmarrë analiza ekonomike të projekteve dhe për të planifikuar investimet, (c) zhvillimi i institucioneve rregullatore më të fuqishme dhe (aty ku është e mundur) dispozita konkurruese në rregullore të lehta, (d) ndryshimi i stimujve për të përmirësuar përgjegjshmërinë e ndërmarrjeve shtetërore dhe ofruesve të shërbimeve që kontrollohen nga qeveria, (e) mbështetje për publikim më të mirë të informacionit dhe mekanizma mbikqyrjeje nga përfituesit apo shoqëria civile, përfshirë qasje të drejtuara nga komuniteti, dhe (f) përmirësimi i proceseve të prokurimit dhe menaxhimit financiar të ministrive të linjës. Këto qasje, të cilat nuk janë të reja për Bankën, do të merren sistematikisht në konsideratë gjatë zhvillimit të programeve dhe projekteve.

## **Kutia 1. Politikat, Procedurat dhe Udhëzimet e Bankës: Përshtatje për të Pasqyruar GAC dhe Nevojat e Klientëve**

Stafi i Bankës udhëhiqet nga politikat, procedurat dhe një numër udhëzimesh të publikuara dhe online. Këto janë në process rishikimi për të pasqyruar qasje të praktikave të mira në qeverisje dhe anti-korrupsion. Ato përfshijnë të mëposhtmet:

- **Udhëzues mbi Strategjitë e Asistencës për Vendet (CAS)**, përfshirë BP2.11, që ka për synim të japë udhëzim më të detajuar në lidhje me çështje të lidhura me qeverisjen, duke përfshirë këshilla të detajuara se si të analizohet natura e rreziqeve të GAC, të regjistrohen mësimet e dala nga praktikatat e mira, dhe shënime se si të konsulohet dhe angazhohet efektivisht shoqëria civile dhe aktorët e tjerë të interesit.
- **Politika e Bankës për publikimin e informacionit dhe detajet e zbatimit të projekteve.** Sipas rregullave të tanishme, Banka nuk publikon sistematikisht informacion për supervizionin e projekteve apo dialogun që bëhet me qeverinë rreth shqetësimeve që dalin gjatë zbatimit. Politika e Operacioneve dhe Shërbimet e Vendit (OPCS) dhe Departamenti Ligjor (LEG) janë duke shqyrtuar mënyra për ta politikën e Bankës për publikim më pak kufizuese.
- **Udhëzimet e INT dhe trainimet e gjera të stafit të Bankës e mbështetur nga INT.** Procedurat existuese do të azhurnohen dhe rishikohen për të patur një impakt më të mirë në zhvillim në kontekstin e programit të vendit, duke marrë, sipas rastit, nga Raporti i Volcker që po përgatitet dhe inpute të tjera.
- **Zgjidhjet ligjore.** Udhëzime nga LEG dhe OPCS mbi qasje më sistematike dhe të përshtatshme për të ushtruar zgjidhjet ligjore.
- **Monitorimi dhe kontrollat e menaxhimit Financiar Publik.** Zbatimi i rekomandimeve kyç të Grupit të Punës së Menaxhimit Financiar Publik dhe Bordit të Sektorit të Menaxhimit Financiar mbi monitorimin dhe kontrollat dhe përpjekjet përkatëse për të zbatuar sistemin e ri të menaxhimit të portofolit dhe riskut (PRIMA), dhe kuadrit të kontrollit të cilësisë së menaxhimit financiar.
- **Rishikimi i politikës së prokurimeve (OPCS)** për të rritur eficientë dhe efektivitetin e rregullave të Bankës për prokurimet (dispozitat e të cilave mbi mashtimin dhe korrupsionin janë tashmë gjerësisht të vlerësuara në nivel ndërkombëtar).

16. Këto dhe masa të tjera zbutëse po përfshihen në hartime “të zgjuara” projekti. Në disa raste, planet e veprimit të qarta të qeverisjes dhe antikorrupsionit janë parë të dobishme në nivel projekti, dhe kjo përvojë do të përhapet. Do të caktohen pikat fokale të GAC në ekipet vendore dhe sektoriale, dhe Rajonet mund të krijojnë shpesh ekipe këshillimore të GAC—si në Shqipëri, Bangladesh, Kamboxha, Indi, dhe Indonezi—ose mekanizma të tjerë për të bërë që çështjet e GAC janë vlerësuar siç duhet në projekte dhe AAA. Rajonet do të sigurojnë gjithashtu që, sipas nevojës, këshillues nga grupet e interesit do të këshillojnë mbi trajtimin e çështjeve të GAC, duke filluar nga faza e konceptimit. Kur partnerët të jenë të integruar plotësisht në këtë përpjekje, IFC dhe MIGA do të përshkallëzojnë disa qasje që janë në zbatim, përfshirë promovimin e rastit të biznesit për GAC si një propozim me vlerë të shtuar për bizneset locale dhe të huaja (“integriteti është i mirë për biznesin”); duke forcuar praktikatat e

qeverisjes korporative të gjithë kompanive me investues; dhe duke vlerësuar kodet e etikës së bizneseve si pjesë e mjedisit të kontrollit korporativ.

17. Plani i zbatimit i GAC ka të bëjë me ndihmën ndaj vendeve për të përmirësuar sistemet e tyre të qeverisjes, në mënyrë që të reduktohet mundësia për të keqpërdorur fondet—ka të bëjë me forcimin dhe parandalimin, më shumë se me policimin dhe sanksionet. Megjithatë, është e qartë që qasjet më sistematike dhe të përshtatshme kanë një rol në forcimin e qasjes së Bankës në GAC. Azhornimi dhe rishikimi i procedurave ekzistuese të Departamentit të Integritetit Institucional të Bankës (INT) do të jetë një aspekt i kësaj, por gjithashtu ka dhe punë tjetër për tu bërë në fushën e zhdëmtimeve. Veçanërisht, ka një nevojë për të zhvilluar një mënyrë për të marrë feedback në të cilën mësimet e nxjerra nga zbatimi i zhdëmtimeve futen në hartimet e ardhshme të projekteve dhe në reformat sektoriale dhe të sistemit të mbështetura nga Grupi i Bankës Botërore.

### C. Nivel Global

18. Ka shumë iniciativa në process për të trajtuar çështjet e GAC, dhe në vendet e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) edhe në vendet në zhvillim. Plani i zbatimit identifikon pesë fusha të veçanta për përfshirje më të madhë të Grupit të Bankës Botërore për të mbështetur iniciativat globale—për të plotësuar angazhimin e sanksionuar në strategjinë e GAC “të mos veprohet vetëm”. Qëllimi është fuqizimi i partneriteteve për të krijuar politika të harmonizuara, për të mbështetur grumbullimin e burimeve, për të adresuar çështjet transnacionale të GAC, dhe për të bërë që veprimet një aktori në sistemin ndërkombëtar të mos zhbëhen apo minohen nga një tjetër. Këto iniciativa përfshijnë:

- a) Mbështetje e intensifikuar për angazhimin e shumë aktorëve të interesit, përfshirë mbështetjen për rrjetet e të mësuarit dhe iniciativat bashkëpunuese të qeverisjes, siç janë Iniciativa e Transparencës së Industrive Nxjerrëse (EITI) dhe iniciativat që po zhvillohen në sektorë të tjerë, siç janë ndërtimi dhe pyjet. Për disa, Banka do të jetë një sponsor (si në EITI), dhe për të tjerë një pjesëmarrëse active.
- b) Në vendet ku sfidat e GAC paraqesin pengesa serioze ndaj zhvillimit, kordinimi më i mirë i donatorëve—përfshirë parimet e përbashkëta të përgjigjes për donatorët në vendet me rrezik të lartë, e zhvilluar nga Rrjeti i Qeverisjes—Veprimi i Përbashkët Kundër Korrupsionit i Komitetit të Asistencës për Zhvillim i OECD (OECD-DAC)<sup>4</sup>—mund të shmangë “konkurrencën negative” dhe të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme përpjekjet për të mbështetur ndryshimin.
- c) Harmonizimi i praktikave investigative me bankat e tjera multilaterale të zhvillimit (MDB) dhe shkëmbim më i mirë informacioni me prokurorët kombëtarë, veçanërisht në lidhje me sanksionet.
- d) Mbështetje e konventave ligjore globale dhe rajonale, me një theks të veçantë mbi rekuperimin e aseteve, veçanërisht duke nxitur vendet të nënshkruajnë dhe zbatojnë Konventën e OKB Kundër Korrupsionit dhe Konventën e OECD Kundër mitëmarrjes, dhe nëpërmjet zhvillimit,<sup>5</sup> dhe promovimit të iniciativës StAR (Stolen Assets Recovery—Rekuperimi i Aseteve të Vjedhura).

<sup>4</sup> Këto parime të ndërhyrjes së përbashkët po pilotohen nëpërmjet OECD-DAC

<sup>5</sup> Emri zyrtar i kësaj konvente është *Konventa e OECD për Luftimin e Mitëmarrjes nga Zyrtarët Publikë të Punëve të Jashtme gjatë Transaksioneve Ndërkombëtare të Biznesit*.

- e) Puna për krijimin e konsensusit mbi mënyrën se si puna me GAC mund të përmirësojë efektivitetin e zhvillimit, përfshirë sponsorizimin e një conference dy-vjetore mbi këto lidhje dhe mbështetjen financiare për kërkime rreth impaktit të çështjeve GAC mbi efektivitetin e zhvillimit.

#### IV. STAFI DHE BUXHETI: MENAXHIMI I NDRYSHIMIT DHE UDHËHEQJA

19. **Stafi.** Një plan zbatimi për një strategji të shëndoshë të mirë-pritur do të arrinte pak pa qasjen e duhur ndaj stafit dhe burimeve. Ai nuk do të kishte sukses edhe nëse çështjet e qeverisjes perceptohen vetëm si një çështje e stafit të një Rrjeti apo Njësie Zëvendës-Presidenciale (VPU), dhe jo, bazuar në parimin që “qeverisja është çështje e të gjithëve”, për të gjithë stafin e Grupit të Bankës Botërore. Ka dy nevoja të ndryshme përsa i përket stafit. Së pari, është thelbësore të identifikohet një grup nga stafi për të vepruar si pika fokale në Rajonet dhe Rrjetet, për tu fokusuar mbi çështjet e GAC, për të bërë pyetjet e duhura në kohën e duhur, dhe për të mbështetur drejtuesit dhe ekipet. Në një kohë që Banka ka disa punonjës të tillë, ka nevojë për një mandate të qartë dhe të përmirësuar për ta, që ata të punojnë në këto role, dhe që të lidhen me njëri-tjetrin nëpërmjet një rrjeti informal.
20. Gjithashtu, është e qartë që në fushat ku ka kërkesa të paplotësuara apo ku mund të priten aktivitete të rritura—për shembull, menaxhimi financiar publik, sistemeve fiducëre, diagnostikën e qeverisjes, reforma gjyqësore dhe mekanizmave të përgjegjshmërisë sociale—do të ketë nevojë për rritje të stafit. Megjithatë, Grupi i Bankës Botërore, do të veprojë me shumë kujdes. Duke hartuar një strategji gjithëpërfshirëse të burimeve njerëzore që mbulon edhe përmirësimin e aftësive të stafit dhe rekrutimin, sipas nevojës. “Ri-aftësimi” is stafit, veçanërisht stafin e këtyre sektorëve, mund të ndihmojë në rritjen e kapaciteteve për të trajtuar çështjet e GAC, dhe prandaj do të zhvillohen kurse trajnimi mbi këto si dhe mbi lidhjet më të mira me kurset ekzistuese, siç janë trajnimet mbi etikën. Nëvojat për aftësi, profilet e stafit, dhe si pasojë boshllëqet në personel nuk mund të gjitha të priten ex-ante, meqenëse këto nevoja do të qartësohen gjatë zbatimit. Prandaj, plan ii burimeve njerëzore dhe trainimi shoqërues do të zhvillohen gjatë vitit të parë të planit të zbatimit të GAC, në bashkëpunim të ngushtë me Rajonet dhe Bordin e të Mësuarit.
21. **Buxhetimi.** Tashmë, disa nga nevojat financiare janë të qarta: Nevojitet mbështetje për proceset e CGAC që do të fillojnë menjëherë; Rajonet dhe Rrjetet janë tashmë të qarta rreth nevojave më kritike për staf për ekspertizë në qeverisje në nivel vendi dhe sektori; dhe një pjesëmarrje më aktive në një numër iniciativash globale siç është StAR do të kenë nevojë të mbështeten financiarisht. Për vitin fiskal 2008, për të mbështetur ngritjen e procesit të zbatimit, është parashikuar një kërkesë prej rreth 14.8 milionë \$, veçanërisht për të mbështetur këto fusha. Kjo do të përfaqësojë një rritje prej tetë përqind mbi buxhetin e përafërt të shpenzimeve prej 167 milionë \$ të lidhur me veprimtaritë e qeverisjes që po mbështeten në buxhetin e tanishëm të vitit 2008 (përfshirë projektet, AAA, dhe detyra të tjera të lidhura me qeverisjen). Mund të pritet që mbështetja shtesë do të duhet të ngrihet përtej këtij niveli, por kjo do të varej nga rezultatet e para, modelet e kërkesës, dhe mësimet nga përvoja fillestare.
22. **Menaxhimi i Ndryshimit dhe Udhëheqja.** Janë rishikuar një numër qasjesh alternative ndaj udhëheqjes së përpjekjeve të qeverisjes dhe anti-korrupsionit në Bankë. Konsideratat rreth udhëheqjes duhet të dominohen nga një aspekt kyç i qasjes që është vënë në dukje tashmë: qeverisja është çështje e të gjithëve. Nëse shqetësimet rreth qeverisjes dhe anti-korrupsionit duhet të pasqyrohen në të gjithë Bankën dhe në gjithë sektorët, dhe të pasqyrohen në

shqetësimet mbi efektivitetin e zhvillimit, GAC nuk mund të shihet si çështje e një njësie të veçantë. Për më tepër, ekzistojnë përparësi në përdorimin e strukturave ekzistuese institucionale. Prandaj, propozohen rregullimet e mëposhtme, të paktën për vitin e parë të zbatimit të GAC:

- a) Axhenda e GAC dhe zbatimi i saj do të vazhdojë të mbikqyret nga Drejtori Administrativ përgjegjës.
- b) Do të krijohet një Komitet Drejtues ose një Këshill Drejtues, që do kryesohet nga Drejtori Administrativ. Ky organ do të përbëhet nga drejtues të nivelit të lartë që përfaqësojnë Rajonet, Rrjetet, dhe njësi të tjera me përgjegjësi për zbatimin e planit. Ky grup do të mbledhet rregullisht për të mbikqyruar përparimin e bërë në zbatim, për të rishikuar stimujt e stafit dhe drejtuesve dhe efektivitetin e tyre,<sup>6</sup> dhe për të siguruar pjesëmarrjen nga i gjithë institucioni.
- c) Do të ketë një Sekretariat për këtë Komitet dhe për Drejtorin Administrativ përgjegjës, i cili do të grumbullonte materiale, do t'i shkëmbente me stafin e përfshirë nga e gjithë Banka, do të zhvillonte një faqe interneti të brendshme dhe të jashtme, dhe do të mbante një listë të personave burimorë; ky Sekretariat do të vendosej praën grupit të Qeverisjes së Sektorit Publik.
- d) Pas një viti, këto rregullime do të rishikoheshin dhe, pasi të vendoset qasja më e mirë për të kanalizuar këtë funksion, do të modifikoheshin në mënyrë të përshtatshme për të plotësuar nevojat e reja.

## V. VLERËSIMI, KOHA, REZULTATET DHE HAPAT E TJERË

23. Siç u vu në dukje, ky plan ka për synim të verë në lëvizje një proces intensiv të të mësuarit në praktikë, si pjesë të një axhënde shumë-vjeçare. Duke patur parasysh interesin e gjerë për këtë axhendë dhe grupet e shumtë të interesit në gjithë botën, është planifikuar që ky projekt-plan t'i nënshtrohet një procesi vlerësimi nga grupet e interesit, përfshirë ata që morën pjesë në konsultimet e suksesshme për vetë strategjinë e GAC. Nëse plani pranohet nga Bordi, zbatimi do të fillonte pas Mbledhjeve Vjetore të 2007.
24. **Reagimi i Grupeve të Interesit.** Nuk konsiderohet e nevojshme që të ketë të njëjtin intensitet të procesit formal të konsultimeve që u krye për vetë Strategjinë e GAC, meqenëse plan i zbatimit nuk rikthehet tek shtytja e strategjisë së GAC, apo tek iniciativat e nivelit vendor, rajonal dhe global. Plani fokusohet më shumë tek pyetja më e ngushtë se çfarë do të bëjë vetë Grupi i Bankës Botërore, përfshirë dhe veprimet dhe iniciativat e brendshme në mbështetje të axhendës së GAC dhe puna me qeveritë dhe grupet e tjera të interesit. Për të marrë feedback specifik rreth planit të zbatimit të GAC, janë planifikuar tre tipe diskutimesh të përqëndruara:
  - a) takime me aktorë kyç interesi të cilët kanë treguar një përfshirje të fortë dhe të angazhuar me Bankën në lidhje me këto çështje gjatë shumë viteve (EXT do të bashkëpunojë me Transparency International dhe ente të tjerë për të organizuar këto diskutime);

---

<sup>6</sup> Sistemet e forcuara të stimujvëmund të përfshijnë analiza të fokusuara peer dhe Rishikime të Përmirësimit të Cilësisë (QERs), rishikimet e Grupit të Sigurimit të Cilësisë (QAG), Udhëzimet e CAS, vlerësimi i Grupit të Pavarur të Vlerësimit (IEG), njohje e duhur e stafit, dhe qasje të tjera të tilla

- b) ky draft do të botohej në faqen e jashtme të internetit të Bankës për gjashtë javët e mëtejshme, për të mundësuar komente dhe feedback nga interneti nga një audiencë të gjerë të grupeve të interesuara;<sup>7</sup> dhe
- c) drafti do të dërgohej tek të gjithë ata që morën pjesë në konsultimet e mëparshme në nivel vendi për vetë strategjinë e GAC (disa Zyra Vendi ku ky grup çështjesh është me interes të madh, mund të zgjedhin të organizojnë diskutime të përqëndruara në vendet e tyre me palët e interesuara dhe të përcjellin rezultatet e këtyre takimeve).

25. **Matja e Progresit dhe Impaktit.** Rezultatet e synuara të këtij plani janë përshkruar në matricën e bashkëngjitur. Siç është vënë në dukje më herët, këto rezultate fokusohen mbi atë që vetë Grupi i Bankës Botërore do të bëjë për veprimet e paraqitura në plan duhet edhe të pasqyrohen në ndryshime në nivel vendi me kalimin e kohës. Sigurisht, ndërtimi i institucioneve, ndryshimi i proceseve të sistemit, dhe forcimi i përgjegjshmërisë institucionale për performancë janë procese afat-gjatë. Megjithatë, kur këto të fillojnë të hedhin rrënjë, duhet të përmirësohen dhe indikatorët e qeverisjes; për shembull, reformat e politikës sektoriale dhe reformat institucionale të mbështetura nga Grupi i Bankës Botërore duhet që të pasqyrohen në kohën e duhur në masat, për shembull, të cilësisë së arsimit apo rrugëve; reforma e institucioneve dhe proceseve të shpenzimeve publike duhet të jenë të dukshme, me kalimin e kohës, në masat për performancën e prokurimeve publike; dhe iniciativat globale duhet të evidentohen nga një transparencë me e madhe korporative në sektorë kyç, dhe disa suksese në rekuperimin e aseteve që vendet i kanë humbur nëpërmjet korrupsionit.
26. gjatë kohës që ky process një-vjeçar i mësimit në praktikë zhvillohet, do të jetë e rëndësishme të regjistrohet progresi dhe të identifikohen sfidat dhe veprimet afat-mesme si dhe të gjithë përmirësimet e nevojshme. Do të zhvillohet një metodologji për të regjistruar progresin e bërë në zbatimin e GAC, e cila do të informojë raportin e progresit të zbatimit, që do të përgatitet pas një viti. Për këtë vlerësim do të kërkohet ekspertiza dhe asistencë e Grupit të Pavarur të Vlerësimit. Duke ju përgjigjur interesit të Bordit mbi zbatimin e strategjisë së GAC, parashikohet raportim i rregullt mbi zbatimin gjatë kohës që strategjia kalizohet.

## VI. RREZIQET

27. Ka një numër rreziqesh që mund të pengojnë impaktin e planit, përfshirë difektet në hartimin e tij, siç janë paraqitur këtu apo siç do të modifikohen, në kohën, segmentet dhe burimet e tij. (Kutia 2 parashtron disa nga këto rreziqe dhe masat zbutëse që propozohen në plan). Rreziku më i madh është a ii “punëve të zakonshme” apo edhe rikthimi në kohën përpara njohjes dhe pranimit të rëndësisë që ka qeverisja për zhvillimin. Është përgjegjësia e Drejtuesve të lartë së bashku me stafin që të sigurohen që kjo nuk do të ndodhë. Prandaj, strategjia më e mirë zbutëse është të vazhdohet që kjo axhendë të mbahet në focus gjatë viteve të para kritike të zbatimit të planit..

---

<sup>7</sup> Një dokument mbi “Elementet e Reja të Planit të Zbatimit” u publikua në faqen e internetit të Bankës në datën 27 Prill 2007, dhe komentet e marra kanë ndihmuar në informimin e planit të zbatimit, përfshirë komentet nga Transparency International që theksonin, inter alia, krijimin e një vizioni të qëndrueshëm dhe të ndarë ndërmjet stafit që lufta kundër korrupsionit është qendrore në mandatin e Bankës kundër varfërisë, duke mbështetur angazhimin e Bankës ndaj axhëndës së GAC nëpërmjet burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore, dhe duke promovuar transparencën e plotë fiskale të huamarrësit dhe një integritet më të madh të sektorit privat. Komentet e tjera ritheksuan shtatë parimet e GAC, dhe theksuan që Banka duhet të kuptojë më mirë better gjendjen ekonomike dhe politike të vendit dhe normat themelore të sjelljes që duhet të ndryshojnë nëse vendet duhet të reduktojnë korrupsionin.

## Kutia 2. Cilët Faktorë Mund të Pëngojnë Impaktin e Planit të Zbatimit të GAC?

Rrezik	Veprim Zbutës
Grupi i Bankës Botërore do t'i kthehet "punës rutinë" gjatë vlerësimit dhe trajtimit të shtrëngimeve të qeverisjes ndaj zhvillimit.	Drejtuesit e lartë komunikojnë me efektivitet rëndësinë e trajtimit të kufizimeve ndaj zhvillimit dhe cakton drejtues vendi dhe sektori që kanë aftësitë, angazhimin dhe burimet që ta transformojnë këtë mesazh në veprim. Zbatimi monitorohet sistematikisht nga Komiteti Drejtues, i mbështetur nga një sekretariat. Sistemet e forcuara të stimujve mund të përfshijnë rishikime të përshtatshme dhe QER, rishikime të QAG, Udhëzime të CAS, vlerësim i IEG, njohjet e stafit, dhe incentive të tjera të burimeve njerëzore mund të ishin faktorë të tjerë të rëndësishëm zbutës.
Angazhimi në GAC shihet nga grupet e brendshme dhe të jashtme të interesit kryesisht që ka të bëjë me anti-korrupsionin në projekte, dhe jo më gjerë si ndihmë ndaj vendeve që të ndërtojnë shtete të afta dhe të përgjegjshme..	Drejtuesit e Lartë komunikojnë qartësisht grupeve të brendshme dhe të jashtme aspektet zhvilluese të punës së GAC, që do të përforcohej nëpërmjet një conference dy-vjeçare. Sistemet e vendit vazhdojnë të forcohen dhe të konsiderohen si mekanizmi i preferuar për të dhënë asistencë në zhvillim, dhe izolimi shmanget. Zhdëmtimet zbatohen në mënyrën e duhur.
Grupi i Bankës Botërore nuk do të kenë kapacitetin apo fleksibilitetin për t'ju përgjigjur shpejt pritshmërive të vendit për mbështetje më të madhe për reformë në qeverisje—që është forcuar si pasojë e konsultimeve globale.	Rajonet, të mbështetura nga Rrjetet, organizojnë stafin dhe burimet e tyre për të rritur kapacitetin e tyre në dhënien e shërbimeve këshillimore për qeverisjen në kohën e duhur. Listat e përmirësuar të konsulentëve dhe burimet e financimit ndihmojnë në plotësimin e mungesave në staf. Fleksibiliteti i buxhetit do të jetë kritik në këtë këndvështrim—në mënyrë që ekipet të mund përgjigjen shpejt në kohën që shfaqen mundësitë..
Mësimet rreth mënyrës së si angazhimi në GAC mund të rrisë perspektivat e zhvillimit nuk mësohen dhe institucionalizohen siç duhet..	Krijimi dhe përhapja e mekanizmave të mësimit nëpërmjet Bordit të Qeverisjes së Sektorit Publik, Kyçet e Rrjetit, dhe promovimit të knferencës dy-vjeçare për të përhapur mësimet rreth lidhjeve ndërmjet qeverisjes dhe zhvillimit.
Koordinimi i donatorëve në vendet ku GAC po pengon seriozisht zhvillimin nuk është i duhur.	Grupi i Bankës Botërore dhe donatorët e tjerë zbatojnë "parimet e përgjigjes së përbashkët"—në process pilotimi nga OECD-DAC—për të forcuar kordinimin në rrethana të vështira. MDB-ve të tjera dhe donatorëve të rinj u kërkohet të bashkohen në këtë përpjekje.

## VII. NJË KUADËR VEPRIMESH DHE REZULTATESH TË QEVERISJES DHE ANTI-KORRUPSIONIT

<i>Fusha e Veprimit</i>	<i>Përshkrim i Aktiviteteve të Bankës</i>	<i>Përgjegjës</i>	<i>Rezultatet</i>
<b><i>Fusha e Veprimit:</i></b> <b><i>Ekipe e vendeve kryejnë një inventarizim të “proçesit të CGAC” për të vlerësuar efektet e GAC për efektivitetin e zhvillimit</i></b>			
Angazhim më i thellë me vendet rreth mënyrës se si çështjet e GAC çënojnë uljen e varfërisë. Mbështetje e vendeve për të zhvilluar programe më të mira për të trajtuar këto çështje dhe për të pasqyruar këtë kuptim më të mirë të CAS.	Çdo ekip vendi që ka një CAS përpara, do të thellojë angazhimin e tij me klientin dhe partnerët e tij për të identifikuar pengesat kritike që qeverisjes dhe korrupsionit ndaj arritjes së qëllimeve të zhvillimit në nivel vendi, sektori dhe projekti, duke vlerësuar rreziqet e zbatimit, reputacionit dhe besimit.	RVP, Ekipe e Vendit	Rritje e ndjeshme dhe e besueshme të programeve GAC të mbështetjes, të përfshira në CAS, deri në fund të FY08.  Këto CAS do të kenë tregues të qartë të qeverisjes për të monitoruar ndryshimet pozitive.
	Çdo ekip vendi do të identifikojë punën e mëtejshme analitike, institucionale ose diagnostike që nevojitet për të përmirësuar njohuritë e Bankës.	RVP, Ekipe e Vendit	
	CAS do të përvijojë një plan biznesi të qartë duke treguar se si synon të mbështesë vendin në trajtimin e çështjeve të GAC në mënyrë më të efektshme për të rritur efektivitetin e zhvillimit dhe ulur varfërinë.	RVP, Ekipe e Vendit	
	Deri në finalizimin e planit të zbatimit në Shtator 2007, Zëvendës Presidentët Rajonalë (RVP) do të miratojnë OPCS, CAS-et e të cilëve të FY08 do të përfshijnë këtë process. Pas një përvoje një-vjeçare dhe vlerësimit të rezultateve të deriatëhershme, do të përcaktohet se si do të mund të kanalizohet ky proçes CGAC.	RVP; OPCS	
<b><i>Fusha e Veprimit</i></b> <b><i>Futja e GAC në sektorë dhe përmirësimi i sistemeve “thelbësore” për efektivitetin e zhvillimit</i></b>			
Vendet janë të pajisura më mirë për të trajtuar çështjet e GAC në nivel sektori, ku mundësitë për ndërhyrja janë shpesh më të menjëhershme.	VPU-të e Rrjetit (NVP) do të zhvillojnë dhe pilotojnë një brez të ri të produkteve AAA të fokusuar në diagnostikën dhe monitorimin e GAC, si specifike për sektorin ashtu dhe ndërsektoriale për tu përdorur në bazë të kërkesës nga klientët dhe ekipet e vendit.	PREM dhe specialistët e sektorëve të NVP	SD dhe HD do të kenë nxjerrë udhëzimet në fushat e transportit, shëndetit dhe arsimit. Sektorët e tjerë do të nxiten të bëjnë të njëjtën gjë.
Ekzistojnë aftësitë e duhura për të trajtuar përmirësimet “thelbësore” të sistemeve të qeverisjes.	Me asistencën e Rrjetit, secili RVP do të identifikojë nëse aftësitë e ekspertizës mbi menaxhimin financiar dhe administrativ publik janë të mjaftueshme për të plotësuar kërkesën.		Strategjia e burimeve njerëzore të GAC nxjerrë së bashku me vlerësimin e vitit të parë.
<b><i>Lehtësimi i angazhimit të ekipit të vendit në anën e kërkuësve të qeverisjes</i></b>			
Vendet mbështeten për t'i aftësuar për të patur një fokus më të fortë mbi kërkuësit e përgjegjshmërisë.	SDN do të (i) sponsorizojë trainimin për vendet dhe stafin e Grupit të Bankës Botërore për t'i mundësuar ata të përfshijnë më mirë iniciativat e kërkuësve dhe shoqërisë civile në programe dhe operacione të mbështetura nga banka; (ii)	SDN, EXT	Rritje e ndjeshme në operacionet e reja në FY08 në të cilat ka mbështetje për kërkuësit në fushën e qeverisjes në të gjitha Rajonet.

<i>Fusha e Veprimit</i>	<i>Përshkrim i Aktiviteteve të Bankës</i>	<i>Përgjegjës</i>	<i>Rezultatet</i>
	sponsorizojë trajnimin për stafin e zhvillimit social për t'i mundësuar ata të punojnë më efektivisht me stafin e sektorëve dhe atë teknik të anës kërkuese të operacioneve të Grupit të Bankës Botërore; (iii) hartojë dhe zbatojë sisteme cilësore menaxhimi dhe M&E për të siguruar efektivitetin e këtyre përpjekjeve tëpërshkallëzuara; dhe (iv) krijojë programe të mësimave se çfarë funksionon, dhe t'i përhapë ato gjerësisht nëpërmjet faqeve të hapura të internetit, trajnimit, kiteve, dhe udhëzimeve.		
Vazhdimi i përvajave të kaluara, sigurimi që burimet janë të disponueshme në kushte të përshtatshme për të mbështetur aktivitetet e kërkuesve.	Puna me partnerët për të zhvilluar një mekanizëm financimi që mund të financojë efektivisht aktivitetet e lidhura me projektet dhe programet, përfshirë ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnimi për grupet e shoqërisë civile, për të plotësuar burimet ekzistuese port ë kufizuara për këtë (fondet e administruara, DGF).	PREM	Mekanizmi i financimit i krijuar dhe grantet e reja të disponueshme në FY08.
Dhënia e udhëzimeve për stafin mbi praktikatat e mira dhe çështjet e mandatit përballë angazhimit të shoqërisë civile.	Përgatitja e udhëzimeve për stafin për angazhimin e shoqërisë civile, përfshirë qasjet për të siguruar role pozitive të shoqërisë civile në këto fusha.	SDN, EXT, LEG	Nxjerrja e dokumentit udhëzues.
<b><i>Puna në bashkëpunim me sektorin privat</i></b>			
Nxitja dhe puna me firmat për të përfshirë anti-korrupsionin në qeverisjen korporative.	IFC dhe WBI do të marrin drejtimin për të intensifikuar përpjekjet për paketën e antikorrupsionit, duke punuar veçanërisht me kompanitë partnere të reja të IFC.	IFC, WBI	Rritje e ndjeshme në angazhimet e IFC dhe WBG në të cilat firmat kanë adoptuar masa më të mira qeverisjeje (përfshirë plane të qarta anti-korrupsioni).
Ndihmë për të profesionalizuar zërin e biznesit të organizuar dhe grupeve të tjera të interesit në dialogun mbi klimën e biznesit.	Përshkallëzimi i programeve të mbështetjes së shoqatave të biznesit, dhomave të tregëtisë, dhe shoqatave profesionale për të forcuar kapacitetet e tyre për të marrë pjesë në dialogun publike të politikave mbi mjedisin e biznesit.	WBI	Këto shoqata do të zhvillojnë programe të reja advokatisje në këtë fushë.
Përmirësimi i cilësisë së angazhimit të WBG në iniciativat bashkëpunuese që caktojnë standartet vullnetare të etikës së biznesit.	Krijimi i një grupi teknik pune nga gjithë WBG për të bërë menaxhimin e njohurive dhe mbështetjen e iniciativave bashkëpunuese globale të fokusuar mbi tregjet; për të identifikuar praktikatat e mira dhe për t'i shkëmbyer ato brenda Bankës si dhe me grupet e interesit jashtë saj; për të bërë kërkime mbi impaktin e tyre mbi zhvillimin; dhe për të thelluar njohuritë tona mbi mënyrën se si këto angazhime vullnetare mund të zbatohen në nivel vendi..	PREM, Grupi i Programeve Globale, IFC Dhe NVP të tjerë	Iniciativat e reja bashkëpunuese adoptojnë programe për të rritur impaktin e tyre zhvillues, përfshirë kodet vullnetare të etikës, aty ku është e mundur.
<b><i>Matja më e mirë e qeverisjes</i></b>			
Vendet, grupet e interesit dhe stafi përdorin më sistematikisht indikatorët për të monitoruar më mirë	Krijimi i një grupi teknik për të promovuar përdorimin më sistematik të indikatorëve të qeverisjes dhe instrumenteve diagnostike në operacionet dhe strategjitë e Bankës	PREM, WBI, dhe OPCS	Nxjerrja e indikatorëve të rinj të qeverisjes dhe udhëzimeve të bashkëngjitura.

<i>Fusha e Veprimit</i>	<i>Përshkrim i Aktiviteve të Bankës</i>	<i>Përgjegjës</i>	<i>Rezultatet</i>
efektivitetin operacional, dhe për të kuptuar lidhjet ndërmjet GAC dhe zhvillimit.	nëpërmjet: edukimit të stafit rreth përdorimit të duhur të tipeve të ndryshme të indikatorëve; angazhimi aktiv i ekipeve operative për të promovuar dhe përgjithësuar përdorimin e indikatorëve të përshtatshëm për monitorimin e performancës së produkteve përkatëse huadhënëse të Bankës.		
	Banka do të mbështesë përdorimin më të gjerë në vend të indikatorëve të Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjshmërisë Financiare (PEFA) do të promovojë publikimin vullnetar nga vendet të indikatorëve dhe analizave të PEFA.	RVPs	Ndërmarrja e PEFA në një numër në rritje vendesh, dhe një numër në rritje vendesh që publikojnë indikatorët e tyre.
	Rrjetet sektoriale do të hartojnë indikatorët e qeverisjes në nivel sektori, dhe do t'i zbatojnë ata në operacionet sektoriale, duke u përqëndruar mbi indikatorët që mund të replikohen në gjithë vendet.	NVP	Nxjerrja e indikatorëve të qeverisjes për transportin, shëndetin dhe arsimin.
	Komiteti i Kërkimit do të nxjerrë një thirrje për propozime për kërkime që eksplorojnë në mënyrë empirike, duke përdorur indikatorë të rinj dhe ekzistues të qeverisjes, marrëdhënien ndërmjet ndërhyrjeve specifike të qeverisjes dhe rezultateve të zhvillimit.	DECVP, Komiteti i Kërkimit	Miratimi i propozimeve të reja të kërkimit në këtë fushë.
<b>Zbatimi i Strategjisë së GAC në Projektet e Bankës</b>			
Vendet i përfshijnë çështjet e GAC më sistematikisht në projektet e tyre, kryesisht për ndërtim kapacitetesh, përfshirë ato të mbështetura nga Banka.	Rritja e numrit të projekteve që përfshijnë elemente për të trajtuar çështjet e GAC, përfshirë ndërtimin e kapaciteteve dhe institucioneve për sistemet e vendit në menaxhim financiar dhe prokurim, llogaridhënia në nivel sektori, dhe pjesëmarrja në vendim-marrje.	RVP, OPCS, WBI	Operacionet e reja përfshijnë ngritjen e kapaciteteve në qeverisjen e sektorëve dhe institucionet fiduciare. Mund të përfshihen indikatorët e ndryshimeve të matshme.
Trajtimi i dimensioneve të GAC të efektivitetit të zhvillimit gjatë gjithë ciklit të projektit.	Ekipeve të vendit dhe të projekteve do të trajtojnë rrezikun e qeverisjes dhe korrupsionit ndaj efektivitetit të zhvillimit gjatë gjithë ciklit të përgatitjes dhe zbatimit të projektit, nëpërmjet mjeteve të tilla si analiza sistematike e rrezikut të korrupsionit në përgatitjen e projektit; "hartim i zgjuar i projektit"; publikim më i mirë i informacionit; mbikqyrje më e fortë, përfshirë analizën e aspekteve që lidhen me GAC në çdo operacion; ndjekje më sistematike e zhdëmtimeve; dhe, aty ku është e përshtatshme, zhvillim i planeve anti-korrupsion specifike për projektin. Sistemet e bankës do të rregullohen për të pasqyruar qasjet e praktikës së mirë mbi qeverisjen dhe antikorrupsionin.	RVP, ekipet e projekteve, OPCS	Udhëzim mbi trajtimin e rreziqeve në projekte, përfshirë rreziqet e GAC, është nxjerrë. Do të përgatitet raporti vjetor mbi mënyrën se si janë trajtuar dhe lehtësuar çështjet e GAC në të gjithë Rajonet.
Forcimi i administrimit cilësor në aspektet e operacioneve të lidhura me GAC.	Për projektet që përfshijnë planet e qeverisjes dhe antikorrupsionit (GAAP) apo masa që lidhen me korrupsionin, supervizioni do të përfshijë analizën e aspekteve që lidhen me GAC, dhe çdo	RVP, ekipet e projekteve, QAG	

<i>Fusha e Veprimit</i>	<i>Përshkrim i Aktiviteteve të Bankës</i>	<i>Përgjegjës</i>	<i>Rezultatet</i>
	raport supervizioni mbi zbatimin (ISR) do të raportojë hapur mbi progresin në zbatimin e GAAP dhe masave që lidhen me projektin për të përmirësuar qeverisjen dhe zbutur korrupsionin.		
	Proçeset e Bankës për menaxhimin e cilësisë do të sigurojnë përshtatshmërinë e mbulimit të dimensioneve të GAC të efektivitetit të zhvillimit për vendin përkatës, AAA dhe produktet operative.	OPCS, RVP	
<b>Strategjia e Zbatimit të GAC në Nivel Global</b>			
Përmirësimi i kordinimit të donatorëve rreth qasjes së GAC.	Harmonizimi i politikave të sanksioneve ndërmjet MDB-ve.	INT/LEG	Marrëveshja mbi harmonizimin e politikave të sanksioneve deri në fund të vitit 2008.
	Vlerësimi i shtrirjes së parimeve të përbashkëta të ndërhyrjes për donatorët, për të përmirësuar kordinimin e donatorëve në vendet me shtrëngesa serioze të GAC nda efektivitetit të zhvillimit.	PREM	
Forcimi i mbështetjes për angazhimin e shumë grupeve të interesit.	Mbështetje në rritje për iniciativat bashkëpunuese të qeverisjes dhe rrjetet si EITI.	EXT, Rrjetet	Dhënia e mbështetjes për marrëveshje të reja ndërmjet aktiviteteve të njëjta (p.sh. industria e ndërtimit).
Mbështetja e konventave globale dhe rajonale mbi GAC.	Intensifikimi i mbështetjes për zbatimin e konventave dhe iniciativave që lidhen me GAC, përfshirë Konventën Kundër Korrupsionit e OKB, dhe Iniciativën e Rekuperimit të Aseteve të Vjedhura (StAR)	PREM, WBI, NVP	StAR ka lehtësuar procesin e rekuperimit të asetëve në vende shtesë.
Mbështetje të mësimit global mbi rrjetin e zhvillimit të GAC.	Kordinimi i një conference dy-vjeçare mbi GAC gjatë takimeve vjetore të WBG. Intensifikimi i kërkimit global mbi impaktin e GAC mbi zhvillimin, përfshirë krijimin e një serie buletinesh elektronike.	DEC, PREM	Konferenca e parë dy-vjeçare në 2008. miratimi i propozimeve përkatëse të kërkimit.
<b>Veprimet Organizative, Burimeve Njerëzore dhe Buxhetore në mbështetje të Zbatimit të GAC</b>			
Identifikimi i një grupi nga stafi për të përmirësuar kordinimin dhe ndërgjegjësimin mbi GAC në RVP dhe NVP.	Ekipe të vendit dhe SMU (brenda RVP dhe pikave kyç të Rrjeteve) do të caktojnë një anëtar të lartë të stafit për të qenë pikë fokale për qeverisjen dhe anti-korrupsionin dhe do të caktojnë kohën në programin e punës për të mundësuar që ky anëtar stafi të këshillojë rreth çështjeve të lidhura me GAC të produkteve të njësisë.	RVP	Krijimi i ekipit nga gjithë Banka përpara fundit të vitit 2007.
	Çdo RVP do të krijojë një proçes dhe/ose strukturë të përshtatshme kordinimi rajonal dhe do ta vërë në funksion në FY08; ky proçes do të funksionojë nën udhëheqjen e një personi të lartë të caktuar nga VP.	RVP	
	Rrjetet, HD dhe SDN secili do të krijojnë menjëherë një grup drejtues në nivel VPU (përfshirë përfaqësues nga RVP) për të lehtësuar dhe monitoruar zbatimin e veprimeve për përgjithësimin e GAC.	HD, SDN	
Forcimi i burimeve njerëzore të Bankës për zbatimin e strategjisë së GAC	Rrjetet, të mbështetura nga pikat fokale Rajonale të qeverisjes, do të punojnë me kordinatorët Rajonalë të të mësuarit për të zhvilluar programet e mësimit që lidhen me GAC, dhe do të identifikojnë mungesat	VPU-të sektoriale me PREM dhe pikat fokale Rajonale	Strategjia e HR të GAC për tu nxjerrë me raportin e vitit të parë.

<i>Fusha e Veprimit</i>	<i>Përshkrim i Aktiviteteve të Bankës</i>	<i>Përgjegjës</i>	<i>Rezultatet</i>
	kritike të stafit të GAC, të cilat mund të kenë nevojë të plotësohen nëpërmjet rekrutimit.		
	Fillimi i një ushtrimi të nevojave dhe vlerësimit të aftësive të GAC, që do të përfundojë deri në analizën e parë vjetore. Plani do të hedhë bazën për një strategji më gjithëpërfshirëse për tu zbatuar në FY09 dhe më tej.	OPCS dhe HR, me PREM, HD, SD, Legal, dhe FP	
Sigurimi i burimeve financiare për zbatimin e GAC, nëpërmjet burimeve të reja dhe alokimeve të brendshme.	Vënia në dispozicion e 14.8 milionë \$ shtesë në burime për të financuar vitin e parë të zbatimit të strategjisë së GAC në FY08, për CGAC (\$2.6m), boshllëqet e menjëhershme të aftësive (\$7.2m), mbështetja e punës së qeverisjes në sektorë, PREM, DEC, WBI (\$2.8m), dhe mbështetja për iniciativat globale dhe komunikimet (\$2.2m).	CSR	Raporti i parë vjetor të detajojë shpenzimet shtesë dhe rezultatet shqëruese.

## SHTOJCA A. INDIKATORËT E QEVERISJES DHE PËRDORIMI I TYRE

1. Qeverisja është shumë-dimensionale. Një sistem i qeverisjes përfshin një llojshmëri të gjerë procesesh, sistemesh, organizatash dhe rregullash (d.m.th. institucione) nga ana e “ofertës” së burokracisë publike dhe nga ana e “kërkesës” nëpërmjet të cilës institucione jo-ekzekutive të mbikqyrjes dhe qytetarët kërkojnë llogari nga burokracia për performancën e saj. Prandaj qeverisja mundë matet duke përdorur (a) *indikatorë të përgjithshëm* të cilët monitorojnë performancën e përgjithshme të sistemit (për shembull, Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International); dhe (b) *indikatorë specifikë* që fokusohen më ngushtësisht mbi cilësinë e elementeve të zërthyer të një sistemi të përgjithshëm qeverisjeje të një vendi (për shembull, nën-indikatorët për menaxhimin financiar publik të Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjshmërisë Financiare, ose PEFA).
2. Megjithëse të dy tipet e indikatorëve janë të dobishëm, ata shërbejnë për nevoja të ndryshme. Indikatorët e përgjithshëm shënojnë më mirë rezultatet e përgjithshme, siç është rritja, ndërsa indikatorët specifikë janë më të përshtatshëm për të monitoruar ndryshimet në fusha të veçanta të qeverisjes. Indikatorët specifikë të qeverisjes kanë gjithashtu më shumë mundësi të jenë të “veprueshëm” (d.m.th., ata japin informacion mbi të cilin mund të veprohet nëpërmjet reformave të veçanta). Megjithatë, vetëm fakti që ato janë të veprueshme nuk do të thotë detyrimisht që ato fokusohen mbi veprime që kanë më shumë lidhje përsa i përket përmirësimit të rezultateve të qeverisjes.
3. Një dallim i mëtejshëm, për të dy llojet e indikatorëve të përgjithshëm dhe specifikë, është ndërmjet (a) masave të cilësisë së vetë *institucioneve dhe proceseve* (“rregullat e lojës”, formale dhe informale), dhe (b) masat e *rezultateve* që prodhohen nga këto institucione. Pashmangshmërisht, për shkak se cilësia e institucioneve dhe asaj që ata “prodhojnë” zakonisht nuk janë drejtpërdrejt të matshme, matja e qeverisëse e rregullave dhe rezultateve do të përmbajë një element subjektivizmi.
4. Tabela 1 tregon një tipologji të indikatorëve. Ajo bën dallimin midis masave të përgjithshme dhe atyre specifike si dhe masave të cilësisë së proceseve/rregullave dhe të rezultateve të prodhuara nga këto rregulla. Siç ilustron në kolonën e dytë dhe të tretë të tabelës, ekziston një llojshmëri indikatorësh specifikë që mund të përdoren për të matur cilësinë e proceseve/rregullave të veçanta të qeverisjes dhe të rezultateve të qeverisjes. Dhe, në vitet e fundit, janë bërë përparime thelbësore si në llojshmërinë ashtu dhe në cilësinë e indikatorëve të qeverisjes.
5. Shembuj të indikatorëve të përdorur gjerësisht që matin proceset apo rregullat përfshijnë:
  - Seti i indikatorëve të *Përgjegjshmërisë së Shpenzimeve dhe Financave Publike (PEFA)* i cili përfshin 28 masa specifike për të shënuar cilësinë e sistemeve të menaxhimit financiar publik, dhe që është zbatuar në mbi 75 vende ([www.pefa.org](http://www.pefa.org)).
  - Nën-indikatorët institucionalë të përfshirë në indeksin e *Vlerësimit të Politikës së Vendit dhe Institucionale (CPIA)* – veçanërisht CPIA 13 (cilësia e sistemeve të menaxhimit

financiar publik) dhe CPIA 15 (cilësia e administratës publike), të cilët janë të disponueshme publikisht për të gjithë vendet që marrin nga IDA ([www.earthbank.org/ida](http://www.earthbank.org/ida)).

- *Indeksi Global i Integritetit (GII)*, i cili mat në një nivel shumë të detajuar cilësinë e rregullimeve check-and-balance për të parandaluar abuzimin me pushtetin, për të ulur korrupsionin, promovuar integritetin publik dhe për tu siguruar qytetarëve akses në qeveritë e tyre në 43 vende ([www.globalintegrity.org](http://www.globalintegrity.org)).
- *Indeksi i Buxhetit të Hapur (OBI)*, i cili vlerëson disponueshmërinë publike të dokumenteve kyç të buxhetit, cilësinë e informacionit që japin këto dokumente, dhe afatet për shpërndarjen e tyre në 59 vende ([www.internationalbudget.com](http://www.internationalbudget.com)).
- *Indeksi i OECD për Prokurimet*, i cili vlerëson cilësinë e sistemeve të prokurimeve në 22 vende pilot ([www.oecd.org](http://www.oecd.org)).
- *Indikatorët e Doing Business*, të cilët matin cilësinë e rregullave rregullatore zyrtare qeveritare për biznesin në 175 vende.

6. Siç e tregon dhe Tabela 1, këto masa specifike në përgjithësi mund të bashkohen drejtpërdrejt për të prodhuar masa të përgjithshme të cilësisë së proceseve/rregullave (siç është një rradhën e dytë të kolonës 2).

**Tabela 1. Një tipologji e indikatorëve të qeverisjes, me Shembuj**

	<b>Matja e cilësisë së Proceseve/rregullave</b>	<b>Matja e Rezultateve</b>
Masa Specifike	Indikatorë PEFA * Nën-indikatorë CPIA* Nën-indikatorët e Indeksit Global të Integritetit (GII) * Nën-indikatorët e Indeksit të Buxhetit të Hapur (OBI) * Indeksi i OECD për Prokurimet* Doing Business	Vlerësimet e Klimës së Investimeve** Studimet e Mjedisit të Biznesit dhe Ndërmarrjeve (BEEPS)** Nën-indikatorë të zgjedhur nga Indikatorët Botërorë të Qeverisjes (ËGI) ***
Masa të Përgjithshme	CPIA i përgjithshëm* GI Ii përgjithshëm * OBI i përgjithshëm* Indeksi i përgjithshëm i DB *	Transparency International*** ËGI*** Freedom House* Polity IV (shtëngesat ekzekutive)*
<i>Burimet</i>	*Vlerësime ekspertësh **Studime ***Kombinim	

7. Kolona e tretë e Tabelës 1 rendit një grup tjetër indikatorësh që matin, në mënyrë të përgjithshme dhe në atë specifike, rezultatet e prodhuara nga institucionet e qeverisjes. Shembujt kryesorë përfshijnë të mëposhtmet:

- a) Studimet e Ndërmarrjeve (nganjëherë etiketohen si Vlerësimet e Klimës së Investimeve dhe, për ECA, Studimi i Mjedisit të Biznesit dhe Ndërmarrjeve, apo BEEPS), të cilat matin deri në 100 vende perceptimet e firmave rreth cilësisë së performancës së

agjencive publike specifike rregullatore dhe infrastrukture (www.enteprisesurveys.org).

- b) Indikatorët Botërorë të Qeverisjes (ËGI) të prodhuar nga DEC dhe WBI, të cilët japin gjashtë matje të agreguara (bazuar në 33 burime të ndryshme studimi) të rezultateve të prodhuara nga sistemet e qeverisjes, përfshirë shtrirjen e korrupsionit, për mbi 200 vende që nga viti 1996. është e rëndësishme të theksohet që ËGI nuk përbën një vlerësim zyrtar të Bankës Botërore për qeverisjen, dhe që ËGI nuk përdoren as për alokimin e burimeve në Bankë/IDA, rol që i takon CPIA në sistemin të IDA të alokimit në bazë të performancës (PBA) (www.govindicators.org).
  - c) Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International ([www.transparency.org/policy\\_research/surveys\\_indices/cpi](http://www.transparency.org/policy_research/surveys_indices/cpi)).
  - d) Indekset e Freedom House të cilat matin gjendjen e të drejtave politike, të drejtat civile dhe liritë ekonomike në gjithë botën ([www.freedomhouse.org](http://www.freedomhouse.org)).
  - e) Matjet e Polity IV të shtrirjes së shtrëngesave ekzekutive mbi fuqinë vendim-marrëse të ekzekutivit ([www.cidcm.umd.edu/polity](http://www.cidcm.umd.edu/polity)).
8. indikatorët e qeverisjes mund të përdoren për qëllime të shumëfishta. Ato mund të përdoren për ndërgjegjësim të përgjithshëm rreth rëndësisë së qeverisjes; si një instrument diagnostik për të informuar reformën e qeverisjes në nivel vendor; për të monitoruar progresin e reformës qeverisëse në kohë dhe për të shënuar përmirësimet në qeverisje në nivel rajonal dhe/ose ndërkombëtar; për të alokuar ndihmën (nga agjencitë dypalëshe dhe shumëpalëshe); për të kryer kërkime mbi impaktin ekonomik dhe përcaktuesve të qeverisjes; dhe për të vlerësuar rrezikun (për shembull, nga agjencitë e rrezikut dhe investitorët).
9. Prandaj, se cili është indikatori i duhur për tu përdorur varet nga qëllimi. Ilustrimet e mëposhtme nënvizojnë katër mënyra të ndryshme në të cilat Banka përdor indikatorët e qeverisjes:
- a) Për alokimin e burimeve të ndihmës:
    - CPIA (dhe në mënyrë më specifike, nën-komponenti i saj i qeverisjes) është indikatori i vetëm i qeverisjes i përdorur në sistemin PBË të IDA, për të alokuar burimet e IDA në vendet e pranueshme.
  - b) Për AAA diagnostike dhe këshillim politik në nivel vendi:
    - Këtu mund të përdoret e gjithë gama e indikatorëve të qeverisjes (të përgjithshëm dhe specifikë; matje procesesh/rregullat apo rezultatesh), dhe sgjedhja varet nga qëllimi i AAA, që mund të përfshijë kuptim më të mirë të situatës së qeverisjes në vend; ndërgjegjësimi në lidhje me këto çështje; diagnoza e thelluar e difekteve specifike të qeverisjes dhe pasojat e tyre; dhe vlerësimi krahasues i cilësisë së nën-sistemeve të qeverisjes.

c) Për hartimin dhe monitorimin e reformave specifike të qeverisjes të mbështetura nga operacionet e Bankës:

- Indikatorët specifikë janë ata të përshtatshmit në këtë pikë—duke zgjedhur se cilët indikatorë specifikë (për shembull, masa specifike brenda PEFA, DB, GII, ose grupeve të të dhënave të studimeve të ndërmarrjeve), në varësi se cilët nga këta indikatorë mund të ndihmojë të gjurmohet më afër progresi në fusha specifike të qeverisjes që janë duke u reformuar. Në nivel sektorial, indikatorët më të përshtatshëm mund të mos jenë studimet apo ekspertiza por indikatorët teknikë të rezultateve të ndjeshëm ndaj përmirësimeve nëpërmjet reformës në qeverisje, përfshirë humbjet në transmetim dhe shpërndarje në energjitikë, apo përqindja e fondeve qendrore që arrijnë tek shkollat.

d) Për kërkimet mund të përdoren dy lloje indikatorësh:

- Për kërkimet mbi rezultatet e përgjithshme të qeverisjes, indikatorë të përgjithshëm ndër-vendor me një mbulim të gjerë të vendit (për shembull ËGI).
- Një axhendë kërkimesh në rritje po lidh indikatorët e rinjë të proceseve specifike me rezultate specifike të qeverisjes (d.m.th. vlerësimi i vlerës vepruese të gamës së gjerë të reformave specifike të qeverisjes).

10. Disa kujtesa të fundit rreth indikatorëve. Sa pari, një indikator është vetëm një mjet për të dhënë një panoramë të përgjithshme të niveleve dhe tendencave në performancën e qeverisjes në nivel vendi ose sektori. Qeverisja është komplekse dhe shumë-dimensionale, dhe vlerësimet e qeverisjes duhet të bazohen mbi një llojshmëri të gjerë indikatorësh, dhe jo vetëm mbi një apo disa të izoluar. Në këtë kontekst, shpesh është e vlefshme për analistët dhe politikë-bërësit për të analizuar të dhënat bazë të detajuara të përdorura për të ndërtuar një indikator të përgjithshëm, së bashku me diagnostikën e thelluar me specifike vendore e qeverisjes dhe anti-korrupsionit.

11. Së dyti, çdo vlerësim i qeverisjes shoqërohet nga toleranca gabimi. Këto nuk janë të vlefshme vetëm për indikatorët e bazuar në të dhëna mbi peceptimet, por janë të pranishme në të gjitha përpjekjet për të matur qeverisjen apo klimën e investimit. Për shumë indikatorë, toleranca e lejuar e gabimit nuk pranohet apo publikohet—d.m.th. shkalla e pasaktësisë (e pashmangshme) gjatë matjes së qeverisjes nuk bëhet e qartë; të tjerë siç është ËGI e tregon këtë tolerancë në mënyrë transparente. Është e rëndësishme që këto përqindje gabimi të merren parasysh gjatë vlerësimit të niveleve dhe ndryshimeve në qeverisje, dhe të pranohet që shumë ndryshime të vogla që vëzhgohen ndërmjet vëzhgimeve dhe me kalimin e kohës nuk ka të ngjarë të kenë rëndësi statistikore apo praktike.

**SHTOJCA B. RAPORT I DREJTORËVE EKZEKUTIVË: *FORCIMI I ANGAZHIMIT TË GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE NË QEVERISJE DHE ANTI-KORRUPSION***

KOMITETI I ZHVILLIMIT  
(Komiteti i Përbashkët Ministerial  
i  
Bordit të Guvernatorëve të Bankës dhe Fondit  
mbi  
Transferimin e Burimeve Reale Vendeve në Zhvillim)

DC2007-0005  
28 Mars 2007

**RAPORT I DREJTORËVE EKZEKUTIVË  
FORCIMI I ANGAZHIMIT TË GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE  
NË QEVERISJE DHE ANTI-KORRUPSION**

Bashkëngjitur për Takimin e Komitetit të Zhvillimit të datës 15 Prill 2007 është një raport drejtuar Drejtorëve Ekzekutivë dhe një document shoqërues me titull “Raport i Drejtorëve Ekzekutivë Forcimi i Angazhimit të Grupit të Bankës Botërore në Qeverisje dhe Anti-Korrupsion”. Dokumenti shoqërues përbëhet nga (i) një përmbledhje një faqe e parimeve udhërrëfyese për angazhimin në qeverisje dhe anti-korrupsion; dhe (ii) Përmbledhjen Ekzekutive të dokumentit që u mbështet në takimin e Drejtorëve Ekzekutivë të mbajtur në 20 Mars 2007.

## KOMITETI I ZHVILLIMIT

### RAPORT I DREJTORËVE EKZEKUTIVË

#### FORCIMI I ANGAZHIMIT TË GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE NË QEVERISJE DHE ANTI-KORRUPSION

Në Takimet e Pranverës 2006, Komiteti i Zhvillimit i kërkoi Grupit të Bankës Botërore (WBG) të hartojnë një strategji të përgjithshme për të ndihmuar vendet anëtare të forcojnë qeverisjen dhe të thellojnë luftën kundër korrupsionit. Në Shtator 2006, WBG paraqiti një dokument, “Forcimi i Angazhimit të Grupit të Bankës Botërore në Qeverisje dhe Anti-Korrupsion”, në Takimet Vjetore në Singapor.

Komiteti i Zhvillimit me këtë rast nxori një komunikatë (DC2006-0017) e cila përfshinte udhëzimin e mëposhtëm:

*“Veprimet për të promovuar qeverisjen e mirë janë kritike për zhvillimin e suksesshëm dhe uljen e varfërisë, dhe prandaj ndihma ndaj vendeve anëtare për këto çështje është e rëndësishme për misionin e Bankës dhe arritjen e MDG. Ndërhyrja efektive dhe e fortë kundër korrupsionit është një pjesë e rëndësishme e kësaj. Objektivi kryesor i punës së bankës për qeverisjen duhet të jetë të ndihmojë zhvillimin e shteteve të afta dhe të përgjegjshme për tu dhënë shërbime të varfërve, promovimi i rritjes së udhëhequr nga sektori privat dhe lufta efektive ndaj korrupsionit. Ne kemi mbështetur angazhimin e Bankës në punën për qeverisje dhe anti-korrupsion. Pronësia dhe udhëheqja vendore janë kyç për një zbatim të suksesshëm. Qeveritë janë partnerët kyç të Bankës në programet e qeverisjes dhe anti-korrupsionit, ndërsa Banka, brenda mandatit të saj, duhet të jetë e hapur për përfshirje me një gamë të gjerë të institucioneve vendore, duke marrë parasysh specifikën e çdo vendi. Ne gjithashtu nënvizuar që parashikueshmëria, transparenca dhe trajtimi i njëtrajtshëm dhe i barabartë ndërmjet vendeve anëtare janë parimet udhërrëfyese të Bankës. Në shtimin e vëmendjes ndaj qeverisjes dhe anti-korrupsionit në Strategjitë e Asistencës për Vendet, ne i kërkuam Bankës të zhvillojë më tej dhe të përdorë indikatorë të zberthyer dhe të veprueshëm, duke pranuar që burimet e IDA do të vazhdojnë të alokohen nëpërmjet Vlerësimit të Politikës së Vendit dhe Institucional dhe sistemit të Alokimit në Bazë të Performancës. Ne pranojmë që strategjia do të zhvillohet gjatë zbatimit dhe në dritën e përvojës, por dokumenti vendos një kuadër për angazhimin e vazhdueshëm të Bankës në këtë veprimtari dhe konsultimin e mëtejshëm që është planifikuar me vendet partnere, me Fondin dhe donatorë dhe organizata shumëpalëshe të tjera, me shoqërinë civile, dhe me sektorin privat. Duke patur parasysh rëndësinë e kësaj çështjeje, ne theksuam rëndësinë e mbikqyrjes nga Bordi të strategjisë gjatë zhvillimit të saj të mëtejshëm dhe pastaj të zbatimit, dhe në presim një raport nga Bordi në takimin tonë të radhës”.*

Në dritën e këtij udhëzimi, WBG ndërmori një raund intensiv të konsultimeve ndërkombëtare për të eksploruar këndvështrimet e grupeve të interesit mba atë se si puna e WBG për qeverisjen dhe anti-korrupsionin mund të forcohet për të ulur varfërinë. Nga 10 Nëntor 2006 deri në 26 Janar 2007, WBG organizoi konsultime me përfaqësues nga qeveritë, agjencitë donatore, parlamente, organizata të shoqërisë civile, sektori privat, media, dhe grupe të tjerë të interesit. Konsultimet u mbajtën në 35 vende në zhvillim dhe 12 vende donatore, gjatë katër veprimtarive globale, dhe nëpërmjet një feedback nga interneti—duke arritur më shumë se 3.200 aktorë të interesit në të gjithë botën. Raporte përmbledhëse të këtyre konsultimeve janë publikuar në faqen e jashtme të internetit të Bankës Botërore.

Drejtuesit paraqitën informacionin nga këto konsultime Drejtorëve Ekzekutivë në 30 Janar 2007. Siç u ra dakord në Bord, Drejtuesit e azhornuan dokumentin që ju paraqit Komitetit të Zhvillimit në Singapor, për të pasqyruar mesazhet kyç nga konsultimet dhe për t'ju përgjigjur çështjeve dhe shqetësimeve të ngritura në Komunikatën e Komitetit të Zhvillimit. Ky version i azhornuar i dokumentit u diskutua në një takim të Komitetit të Efektivitetit të Zhvillimit (CODE) të Bordit, në 7 mars 2007. Sugjerimet dhe komentet e bëra në takimin e CODE u përfshinë në një version të rishikuar të dokumentit që u diskutua në një takim zyrtar të Drejtorëve Ekzekutivë në 20 Mars 2007. Në këtë takim, Drejtorët Ekzekutivë në mënyrë unanime mbështetën Strategjinë, dhe ranë dakord t'i dërgojnë për informacion Komitetit të Zhvillimit dokumentin e bashkëngjitur, “Forcimi i Angazhimit të Grupit të Bankës Botërore në Qeverisje dhe Anti-Korrupsion”, i cili është Përmbledhja Ekzekutive e versionit të gjatë të strategjisë të mbështetur nga Bordi.

Një plan zbatimi është duke u përgatitur dhe do t'i dorëzohet Drejtorëve Ekzekutivë deri në fund të vitit fiskal në vazhdim.

**FORCIMI I ANGAZHIMIT  
TË GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE  
NË QEVERISJE DHE ANTI-KORRUPSION**

## SHKURTIME DHE AKRONIME

CPIA	Vlerësimi i Politikës dhe Institucional i Vendit
DEC	Development Economics
EITI	Iniciativa e Transparencës së Industrive Nxjerrëse
GAC	Qeverisja dhe Anti-korrupsioni
IBRD	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
IDA	Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
IMF	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INT	Departamenti i Integritetit Institucional
MDB	Bankë shumëpalëshe e zhvillimit
MDG	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
MIGA	Agjencia Shumëpalëshe e Garantimit të Investimeve
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PBA	Sistemi i alokimit me bazë performancën
PEFA	Përgjegjshmëria e Shpenzimeve dhe Financiare Publike
OKB	Kombet e Bashkuara
WBG	Grupi i Bankës Botërore
WBI	Instituti i Bankës Botërore

## **PARIMET UDHËHEQËSE PËR FORCIMIN E ANGAZHIMIT TË GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE NË QEVERISJE DHE ANTI-KORRUPSION**

1. Fokusi i Grupit të Bankës Botërore (WBG) mbi qeverisjen dhe anti-korrupsionin (GAC) bazohet mbi mandatin e tij për të ulla varfërinë – një shtet i aftë dhe i përgjegjshëm krijon mundësi për njerëzit e varfër, jep shërbime më të mira, dhe përmirëson rezultatet e zhvillimit.
2. Vendi ka përgjegjësinë parësore për përmirësimin e qeverisjes—pronësia dhe udhëheqja nga ana e vendit janë kyç për zbatimin e suksesshëm, dhe WBG është i angazhuar të mbështesë prioritetet e një vendi. Qeveria e vendit mbetet pala kryesore për WBG.
3. WBG është i angazhuar për të ruajtur angazhimin në luftën kundër varfërisë, dhe për të kërkuar mënyra krijuese në dhënien e mbështetjes, edhe në vendet e keq-qeverisura—“mos bëj që të varfërit të paguajnë dy herë”.
4. Forma e angazhimit të WBG në GAC do të ndryshojë nga vendi në vend, në varësi të rrethanave specifike—ndërsa nuk ka “një prerje për të gjithë”, WBG do të adoptojë një qasje të qëndrueshme ndaj vendimeve operative në gjithë vendet, të lidhur sistematikisht me strategjitë vendore, të mbështetur nga Strategjiti e Asistencës së Vëndit (CAS), pa ndryshim në sistemin e alokimit në bazë të performancës për vendet e IDA-s apo sistemin e IBRD të alokimit të burimeve.
5. Përfshirja sistematike me një numër të gjerë të aktorëve të interesit nga qeveria, biznesi dhe shoqëria civile është kyç për reformën e GAC dhe rezultatet e zhvillimit—kështu që, në përputhje me mandatin e tij, WBG do të përshkallëzojë praktikën e mira ekzistuese në angazhimin e grupeve të shumëfishta të interesit në punën e tij operative, përfshirë forcimin e transparencës, pjesëmarrjes, dhe monitorimin nga palët e treta në operacionet e tij.
6. WBG do të përpiqet të forcojë, dhe jo të anashkalojë, sistemet e vëndit—institucione më të mira kombëtare janë zgjidhja më efektive dhe afat-gjatë për sfidat e qeverisjes dhe anti-korrupsionit dhe për zbutjen e rreziqeve të përgjegjshmërisë për të gjithë paratë publike, përfshirë dhe ato që vinë nga Banka.
7. WBG do të punojë me donatorët, institucionet ndërkombëtare, dhe aktorët e tjerë në nivel vendor dhe global për të siguruar një qasje dhe kordinim të harmonizuar bazuar në mandatet përkatëse dhe avantazhe krahasuese—“WBG nuk do të veprojë i izoluar”.

## FORCIMI I ANGAZHIMIT TË GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE NË QEVERISJE DHE ANTI-KORRUPSION

1. Ky dokument shtjellon strategjinë e Grupit të Bankës Botërore (WBG) për të rritur fokusin e tij mbi qeverisjen dhe antikorrupsionin (GAC) si një pjesë përbërëse e punës së tij për të ulur varfërinë dhe për të promovuar rritjen. Ky është një version i azhornuar i dokumentit që ju paraqit Komitetit të Zhvillimit në Singapor, Shtator 2006. Në bazë të udhëzimit dhe të çështjeve të ngritura nga Komiteti i Zhvillimit, WBG ndërmori një raund intensiv konsultimesh ndërkombëtare për të eksploruar këndvështrimet e grupeve të interesit mbi atë se si puna e WBG në qeverisje dhe anti-korrupsion mund të forcohet për të ulur varfërinë.
2. ***Përshkrim i Konsultimeve.*** Nga data 10 Nëntor 2006, deri në 26 Janar 2007, WBG organizoi konsultime me përfaqësues nga qeveria, agjencitë donatore, parlamente, organizata të shoqërisë civile, sektori privat, media dhe grupe të tjerë interesi. Konsultimet u organizuan në 35 vende në zhvillim dhe 12 vende donatore, gjatë katër veprimtarive globale, dhe nëpërmjet një feedback nga interneti—duke arritur më shumë se 3.200 aktorë interesi në të gjithë botën. Raportet e përmbledhura të këtyre konsultimeve janë publikuar në internet. Konsultimet zbuluan një konvergencë të habitshme këndvështrimesh, e cila është përfshirë në strategjinë e azhornuar të paraqitur këtu. Të gjitha grupet e interesit njohën sfidat e veçanta që i bëhen zhvillimit nga qeverisja e keqe dhe korrupsioni dhe mirëpritën interesin e WBG në dhënien e një mbështetjeje më të fortë për trajtimin e këtyre sfidave. Pyetja nuk është nëse por si EB Gmund të jetë një partner i dobishëm për reformën e GAC në rrethana të ndryshme. Konsultimet kanë hapur pika të reja dhe partneritete të mundshme dhe kanë treguar drejtimit për angazhim më të gjerë dhe të thellë. Ato kanë krijuar gjithashtu pritshmëri të larta që Banka do të bazohet mbi këto konsultime duke përfshirë mësimet e nxjerra dhe duke dhënë mbështetje më të madhe.
3. ***Qeverisja dhe Korrupsioni.*** Qeverisja dhe korrupsioni nuk janë sinonime. Qeverisja i referohet mqnyrës në të cilën zyrtarët dhe institucionet publike marrin dhe ushtrojnë autoritetin për të formuar politikën publike dhe për të dhënë të mira dhe shërbime publike. Korrupsioni është një rezultat i qeverisjes së keqe, duke përfshirë abuzimin e postit publik për përfitime personale. Posti publik abuzohet kur një zyrtar pranon, kërkon apo merr një mitë dhe kur agjentët privatë japin apo ofrojnë ryshfet për të anashkaluar politika dhe proçese publike për avantazhe në konkurrencë dhe fitime. Gjithashtu abuzohet nëpërmjet partonazhit dhe nepotizmit, vjedhjes së asetëve shtetërore, apo devijimit të të ardhurave shtetërore. Korrupsioni mund të kryhet edhe ndërmjet palëve të sektorit privat, duke ndërvepruar dhe ndikuar mbi performancën e sektorit publik.
4. ***Qëllimi kryesor i angazhimit të WBG në qeverisje dhe anti-korrupsion është të mbështesë uljen e varfërisë.*** Çdo ditë, njerëzit e varfër në gjithë globin nuk janë në gjendje të kenë akses në klinika shëndetësore, shkolla apo shërbime të tjera thelbësore sepse sistemet e tyre publike nuk janë në gjendje të përgjigjen, apo sepse ata vetë nuk janë në gjendje ose nuk duan të paguajnë ryshfet. Korrupsioni dhe qeverisja e keqe shpesh do të thotë që burimet që duhet të ushqejnë rritjen ekonomike dhe të krijojnë mundësi për njerëzit e varfër që t'i shpëtojnë varfërisë, përdoren për të pasuruar elita të korruptuara. Aty ku mekanizmat e transparencës dhe përgjegjshmërisë janë të dobët apo mungojnë, nevojat e njerëzve të varfër shpesh lihen

mënjandë dhe rezultatet e zhvillimit cënohen. Në disa raste, qeverisja shumë e keqe dhe korrupsioni kanë kontribuar në kolapse financiare dhe ekonomike, tjetërsim të publikut, dhe dhunë dhe shtete të dështuara, me pasoja shkatërrimtare për të varfërit. Prandaj, përmirësimi i qeverisjes dhe reduktimi i korrupsionit janë kritikë në ndihmën që njerëzit e varfër t'i shpëtojnë varfërisë, dhe ndihma ndaj vendeve për të arritur Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (MDGs).

5. Prandaj, puna e WBG për GAC ka si synim zhvillimin e shteteve të aftë dhe të përgjegjshëm që mund të hartojnë dhe zbatojnë politika të shëndetshme, të japin shërbime publike, të caktojnë rregulla që qeverisin tregjet, dhe të luftojnë korrupsionet, duke ndihmuar në këtë mënyrë uljen e varfërisë. Qëndrimi i shtetit dhe i aktorëve të tjerë të interesit, siç janë sektorët privatë dhe financiare, i jep formë cilësisë së qeverisjes dhe ka një impakt mbi rezultatet e zhvillimit. Rregulat e tepërta, për shembull, rritin kostot e biznesit dhe shpesh japin mundësi për korrupsion. Nga ana tjetër, reformat që qartësojnë rolin e shtetit, reduktojnë barrën e tepërt rregullatore dhe promovojnë konkurrencën mund të rezultojnë në firma më të fuqishme, më shumë vende pune, dhe shërbime më të mira publike. Prandaj reforma e qeverisjes dhe anti-korrupsioni janë thelbësore për të ndihmuar WBG në misionin e tij kryesor në shërbim të të varfërve.
6. Përveç mandatit të tij zhvillues për uljen e varfërisë, WBG ka edhe një detyrim përgjegjshmërie, të sanksionuar në Nenet e Marrëveshjes, për të siguruar që fondet e tij përdoren për qëllimet që janë dhënë. Fondet e ndihmës përballen me rreziqe nga korrupsioni dhe qeverisja e keqe, dhe të dy palët donatori dhe marrësit e ndihmës duan siguri që kjo asistencë do të mbrohet. Në frymën e kuadrit të përgjegjshmërisë së dyanshme të Konsensusit të Monterrey, përpjekjet për të forcuar qeverisjen dhe për të rritur sasinë e ndihmës duhet të ndërmerren paralelisht për të ndihmuar vendet të arrijnë MDG.
7. *Një Axhendë në Evoluim*. GAC ka qenë në axhendën e WBG që në momentin e fjalimit të James Eolfensohn mbi “kancerin e korrupsionit” në Takimet Vjetore WBG-IMF 1996; *Ndihma ndaj Vendeve për të Luftuar Korrupsionin: Roli i Bankës Botërore* në 1997; Raporti i Zhvillimit Botëror, *Shteti në një Botë në Ndryshim* 1997; dhe dokumenti strategjik i Bankës Botërore, *Reformimi i Institucioneve Publike dhe Forcimi i Qeverisjes* 2000. Gjatë dekadës së fundit është akumuluar një pasuri dhe përvojë kërkimore—shpesh të udhëhequra nga inovacione me bazë vendore. Qeveritë në të gjithë botën po përpiqen të përmirësojnë qeverisjen dhe të luftojnë korrupsionin, dhe ata po kërkojnë mbështetje dhe mësim nga përvoja ndërkombëtare për të hartuar dhe zbatuar programe komplekse reforme, për të krijuar koalicione mbështetëse, dhe për të monitoruar impaktin e tyre. Institucionet e zhvillimit kanë mundësinë dhe përgjegjësinë që t'i ndihmojnë, dhe Banka po përgjigjet nëpërmjet një angazhimi në rritje të parashtruar në këtë dokument.
8. *Parimet Udhërrëfyese*. Proçesi i përgatitjes së kësaj strategjie—përfshirë udhëzimin nga Bordi i Bankës, Komiteti i Zhvillimit, dhe konsultimet me grupet e interesit—ka ndihmuar në kristalizimin e shtatë parimeve për punën e WBG në GAC. Këto parime udhërrëfyese pasqyrojnë një consensus në rritje, dhe bazohen në mësimet e përvojës. Parimet janë:
  1. Fokusi i Grupit të Bankës Botërore (WBG) mbi qeverisjen dhe anti-korrupsionin (GAC) bazohet mbi mandatin e tij për të ulla varfërinë – një shtet i aftë dhe i përgjegjshëm krijon mundësi për njerëzit e varfër, jep shërbime më të mira, dhe përmirëson rezultatet e zhvillimit.

2. Vendi ka përgjegjësinë parësore për përmirësimin e qeverisjes—pronësia dhe udhëheqja nga ana e vendit janë kyç për zbatimin e suksesshëm, dhe WBG është i angazhuar të mbështesë prioritetet e një vendi. Qeveria e vendit mbetet pala kryesore për WBG.
3. WBG është i angazhuar për të ruajtur angazhimin në luftën kundër varfërisë, dhe për të kërkuar mënyra krijuese në dhënien e mbështetjes, edhe në vendet e keq-qeverisura—“mos bëj që të varfërit të paguajnë dy herë”.
4. Forma e angazhimit të WBG në GAC do të ndryshojë nga vendi në vend, në varësi të rrethanave specifike—ndërsa nuk ka “një prerje për të gjithë”, WBG do të adoptojë një qasje të qëndrueshme ndaj vendimeve operative në gjithë vendet, të lidhur sistematikisht me strategjitë vendore, të mbështetur nga Strategjiti e Asistencës së Vendit (CAS), pa ndryshim në sistemin e alokimit në bazë të performancës për vendet e IDA-s apo sistemin e IBRD të alokimit të burimeve.
5. Përfshirja sistematike me një numër të gjerë të aktorëve të interesit nga qeveria, biznesi dhe shoqëria civile është kyç për reformën e GAC dhe rezultatet e zhvillimit—kështu që, në përputhje me mandatin e tij, WBG do të përshkallëzojë praktikën e mira ekzistuese në angazhimin e grupeve të shumfishta të interesit në punën e tij operative, përfshirë forcimin e transparencës, pjesëmarrjes, dhe monitorimin nga palët e treta në operacionet e tij.
6. WBG do të përpiqet të forcojë, dhe jo të anashkalojë, sistemet e vendit—institucione më të mira kombëtare janë zgjidhja më efektive dhe afat-gjatë për sfidat e qeverisjes dhe anti-korrupsionit dhe për zbutjen e rreziqeve të përgjegjshmërisë për të gjithë paratë publike, përfshirë dhe ato që vinë nga Banka.
7. WBG do të punojë me donatorët, institucionet ndërkombëtare, dhe aktorët e tjerë në nivel vendor dhe global për të siguruar një qasje dhe kordinim të harmonizuar bazuar në mandatet përkatëse dhe avantazhe krahasuese—“WBG nuk do të veprojë i izoluar”.

Në punën me qeverisjen dhe anti-korrupsionin, përfshirë dhe ndërveprimin me partnerë të tjerë, institucionet e WBG duhet të veprojnë brenda kufijve të vendosura nga kufizimi i përgjithshëm i Neneve mbi ndërhyrjen në çështjet politike të një vendi anëtar dhe bazimin e vendimeve mbi karakterin politik të një anëtarit, apo mbi konsiderata jo-ekonomike. Duke ruajtur praktikën ekzistuese, si pjesë e kuadrit të përgjithshëm të bashkëpunimit me anëtarët e tij, në ndërmarrjen e angazhimit nga shumë grupe të interesit, WBG do të sigurohet, në bashkëpunim me qeverinë, që të punojë brenda kuadrit kushtetues dhe ligjor të vendit, do të kërkojë miratimin e qeverisë atëherë kur kërkohet nfa politikat dhe procedurat e tij operative, dhe do të shmangë angazhimet që nuk janë në përputhje me kuadrin e Neneve.

**9. Mësimet e Përvojës.** Strategjia e forcuar e WBG për qeverisjen dhe antikorrupsionin bazohet në më shumë se një dhjetëvjeçar përvoja globale duke punuar me partnerët vendorë, donatorë dhe shoqërisë civile. Mësimet kyç përfshijnë:

- Një numër i lartë kërkimesh tregon se në afat të gjatë, qeverisja e mirë është e lidhur me rritjen e shëndetshme, pabarazi më të ulët në të ardhura, vdekshmëri foshnjore dhe analfabetizëm më të ulur; konkurrencë më të mirë dhe klimë investimesh më të mirë; dhe një ripërtëritje më e mirë e sektorit financiar. Kërkimet tregojnë gjithashtu që

projektet e ndihmës kanë më shumë të ngjarë të kenë sukses në mjediset e mirë-  
qeverisur.

- Reformat institucionale mund të kenë sukses, veçanërisht kur ka një udhëheqje të angazhuar të vendit dhe një koalicion reformativ, kështu që programet e WBG duhet të punojnë ngushtësisht me drejtuesit e reformave në qeveri dhe në bashkëpunim me një gamë të gjerë grupesh interesi.
- Sfidat e qeverisjes janë shumë pak uniforme në vende të ndryshme, kështu që strategjitë e WBG duhet të diferencohen dhe të bazohen fort në njohuritë vendore, inovacionin në terren dhe konsultime dhe bashkëpunim të gjerë me mbështetësit vendorë.
- Forcimi i përgjegjshmërisë kërkon kapacitet në qeveri dhe institucione jashtë pushtetit qendror, siç janë parlamenti, shoqëria civile, media, dhe komunitetet lokale, si dhe një mjedis aftësues në të cilin këta grupe interesi të funksionojnë me përgjegjësi dhe efektivitet.
- Barra e tepërt rregullatore dhe ndërmarrjet jo-rentabël të sektorit shtetëror mund të lidhen me qeverisjen e keqe dhe korrupsionit. Një sektor privat i gjallë, konkurrencës dhe i përgjegjshëm mund të jetë një burim i fuqishëm mbështetjeje për qeverisje më të mirë.
- Edhe kur mundësitë për reformë të qeverisjes në nivel kombëtar janë të kufizuara, mund të ketë pika fillestare në nivel lokal. Në disa rrethana, pika fillestare mund të jetë një reformë pjesëmarrëse nga poshtë lart, siç është zhvillimi i nxitur nga komuniteti, veçanërisht në rastet kur mbështet edhe zhvillimin e transparencës, kapacitetit dhe përgjegjshmërisë së pushtetit lokal.
- Megjithëse ka patur progres në luftimin e korrupsionit administrative, korrupsioni i rrënjosur thellë politik apo sistematik—përfshirë lidhjen ndërmjet parasë dhe politikës dhe kapja e institucioneve shtetërore nga disa interesa të fuqishme në nivel kombëtar dhe lokal—është më i vështirë për tu trajtuar. Në këto raste, ndërhyrjet tradicionale të menaxhimit të sektorit publik duhet të plotësohen me transparencë dhe reforma përkatëse si dhe angazhim më të gjerë me shumëkombëset, sektorin privat vendës, sektorin financiar dhe shoqërinë civile.

Të gjitha këto mësimet shfaqin nevojën për një angazhim të ndjeshëm të Bankës në terren, dhe një perspektivë afatgjatë që pranon reformën e qeverisjes si një përpjekje e vazhdueshme, me ndryshime të mëdha nga një vend në tjetrin.

10. **Rritje e Bazuar në Mësimet e Nxjerra.** Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, WBG është angazhuar në shumë iniciativa GAC në nivel vendi, sektori dhe projekti, të udhëhequr shpesh nga inovacionet në vendore. Përvoja e WBG në mbështetje të reformave ka qenë e përzierë. Megjithëse shumë iniciativa kanë qenë të suksesshme, në përgjithësi ato kanë qenë ad hoc dhe jo të zbatuara njëtrajtësisht në gjithë vendet. Gjithashtu, donatorët nuk kanë qenë të qëndrueshëm, duke dërguar sinjale të ndryshme qeverive në lidhje me rëndësinë e reformave të GAC, duke dobësuar efektivitetin e tyre potencial. Megjithëse disa vende kanë treguar përmirësime në qeverisje dhe anti-korrupsion, të tjerë janë përkeqësuar. Me qëllim që të bëhet një progress më i madh, ka një nevojë për të çuar më tej mësimet e nxjerra dhe për të shtrirë më

sistematikisht qasjet e suksesshme në një mënyrë të qëndrueshme në gjithë vendet. Për Bankën, një qasje e rritur do të thotë gjithashtu dhe rishikim i stafit, aftësive, përdorimit të burimeve dhe stimujve që drejtojnë menaxherët dhe stafin.

11. **Strategjia e Grupit të Bankës Botërore.** Strategjia e WBG është të ndihmojë qeveritë e vendeve, në dritën e sfidave të tyre të dallueshme kombëtare, që të identifikojnë prioritetet e tyre në përmirësimin e qeverisjes dhe për të paraqitur dhe zbatuar programe që u përgjigjen këtyre prioriteteve, në një mënyrë që është efektive dhe e qëndrueshme. Strategjia ndërmerr një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin punën në nivel vendi, operativ, dhe global për të përmirësuar dhe integruar masat e qeverisjes dhe anti-korrupsionit, duke përdorur gamën e plotë të aktiviteteve të WBG për të ndihmuar vendet partnere në arritjen e rezultateve të demonstrueshme për ulje të qëndrueshme të varfërisë. Strategjia kërkon të çojë përpara mësimet e përvojës, të zgjerojë sistematikisht programet që kanë një sukses të provuar, përfshirë programet që forcojnë menaxhimin publik dhe qeverisjen në infrastrukturë, industritë nxjerrëse, shëndet dhe arsim, dhe në sektorët private dhe financiare. Shumë nga këto programe fokusohen mbi rritjen e transparencës së vendim-marrjes, dhe përfshijnë përfituesit dhe grupe të tjera interesi në politikë-bërje dhe mbikqyrje. Përveç kësaj, strategjia ka për synim të sigurojë standarte përgjegjshmërie në operacionet e financuara nga Banka, në shumicën e rasteve duke parandaluar mundësitë për korrupsion nëpërmjet hartimit më të mirë të projekteve, publikim më i mirë informacioni, pjesëmarrje më e madhe, dhe monitoring dhe mbikqyrje e forcuar.
12. **Nivel Vendi.** Një fokus qendror i punës së Bankës është mbështetja e zhvillimit të shteteve më efektive dhe të përgjegjshme, në partneritet me aktorë të tjerë, duke përfshirë organizatat shumëpalëshe dhe dypalëshe. Reformat për forcimin e përgjegjshmërisë dhe transparencës së institucioneve shtetërore janë një fokus i rëndësishëm në rritje të vendeve partnered he, në këtë mënyrë, Banka ka nevojë të japë një asistencë më të qëndrueshme, të vazhdueshme dhe sistematike programeve të qeverive në qeverisje dhe antikorrupsion. Për huamarrësit e IDA, huadhënia dhe alokimi i granteve do të vazhdojë të bazohet në sistemin e Bankës për alokimin në bazë të performancës; për huamarrësit e IBRD, alokimet do të vazhdojnë të pasqyrojnë vlefshmërinë kredituese si dhe shqetësimet në lidhje me performancën dhe qeverisjen. Në të gjitha rastet, një nga objektivat kyç do të jetë trajtimi i njëtrajtshëm i vendeve.
13. **Qasja e Njëtrajtshme në Gjithë Vendet.** Një system sistematik dhe i disiplinuar i CAS, me vëmendje përgjithsuese ndaj sfidave të GAC, do të jetë baza për sigurimin e një qasjeje të njëtrajtshme në gjithë vendet. Ky proces do të sigurojë që strategjia përpunet, në një mënyrë transparente dhe konsultative, me sfidat që qeverisja e keqe mund të shkaktojë për rritjen dhe uljen e varfërisë në vend. Natyra në evoluim, komplekse dhe e ndryshme e rrethanave të vendeve e bën të padëshirueshme klasifikimin e ngurtë të vendeve në ndonjë mënyrë; nuk po merret në konsideratë asnjë listë apo renditje vendesh. Në vend të kësaj, në vendet ku qeverisja është një çështje qendrore për reduktimin e varfërisë, formulimi dhe zbatimi i CAS do të mbështetet nga diagnoza të përshtatshme dhe do të ketë qeverisjen se një temë qendrore, në mbështetje të vetë prioriteteve të vendit. Ka mjaft mënyra për të përfshirë qeverisjen në CAS, pa një qasje “një prerje për të gjithë”. Edhe në vendet më të keq-qeverisura, WBG do të kërkojë të jetë i angazhuar, në disa raste me strategji të ndërmjetme më të shkurtra, në një kohë që nxitet marrëveshje me qeverinë për prioritetet afat-mesme. Nëse ka një mundësi thelbësore që mjedisi i qeverisjes do të ndryshojë gjatë periudhës së CAS në një mënyrë që do të prekë në mënyrë të ndjeshme efektivitetin e ndihmës, në cas mund të specifikohen qartësisht skenare alternative për zbatimin e programit, me kushte për kalimin nga një skenar në tjetrin. Këto

konsistojnë në veprime të monitorueshme që duhet të ndërmerren nga qeveria. Nëse garantohet ndonjë rregullim i mëtejshëm në mes të rrugës, Bordit do t'i paraqitet për diskutim një Raport Progresive ose një document tjetër i përshtatshëm.

14. ***Performance e Qeverisjes dhe Asistenca e WBG.*** Për huamarrësit e pranueshëm nga IBRD, CAS vendos paketa huaje të IBRD që rrjedhin nga analiza e vlefshmërisë kredituese e Bankës, e cila merr në konsideratë qartësisht qeverisjen kur ajo pengon stabilitetin politik ose politikat dhe rezultatet ekonomike. Në vendet që janë të pranueshme për IDA, kjo lidhje arrihet nëpërmjet sistemit të alokimeve në bazë të performancës (PBA). Pësha e madhe që i është caktuar qeverisjes në PBA, nëpërmjet Vlerësimit të Politikës dhe Institucional të Vendit (CPIA), siguron që vendet që qeverisen më mirë marrin një pjesë më të madhe për frymë nga burimet e IDA. Banka do të vazhdojë të mbështetet në PBA për të alokuar burimet e pakëta të IDA ndërmjet vendeve me të ardhura më të ulëta.
15. ***Ruajtja e Angazhimit, edhe në Rrethanat e Qeverisjes më të Keqe.*** WBG do të kërkojë të ruajë angazhimin, edhe në vendet me qeverisje më të keqe. Në këto rrethana të jashtëzakonshme, ku pushteti qendror nuk mund të administrojë të ardhurat nga operacionet e Bankës, WBG do të kërkojë mënyra krijuese angazhimi për të çuar shërbimet drejtpërdrejt tek të varfërit duke përdorur instrumente të tilla si zhvillimi i nxitur nga komuniteti dhe sistemet e shërbimeve të tretëve që nuk varen nga administrimi qeveritar për disbursimin e burimeve. Banka do të kërkojë gjithashtu të përdorë dialogun e politikave, punën analitike dhe asistencën teknike për tu përpjekur të krijojë mbështetje për një angazhim më të madh në qeverisje. Në rastet e rralla kur Banka dhe qeveria nuk mund të bien dakord rreth një programi efektiv të reformës së qeverisjes, Banka do të përgatisë një document strategjie të ndërmjetme që përshkruan fushat e kufizuara që vlerësohen që kanë potencial për impakt pozitiv zhvillimi si dhe paraqet kushtet për të kaluar ndrejt një CAS të rregullt kur të ketë progres. Në këto kushte, IFC dhe MIGA mund të luajnë akoma role kyç si partnerë në ndjekjen e një politike investimesh shoqërisht e përgjegjshme (sin ë rastet e tjera), meqënëse angazhimi strategjik me sektorin privat mbetet një instrument i rëndësishëm për ndryshim në rrethanat me rrezik të lartë.
16. ***Pikat e Ndërhyrjes për Reformë.*** Shtrirja, segmentet dhe shpejtësia e reformave të GAC do të përshtatet me kontekstin e vendit dhe programin e qeverisë. Aty ku udhëheqja e vendit po ndërmerr reforma të mëdha qeverisjeje dhe antikorrupsioni, Banka do t'i përgjigjet kësaj vendosmërie duke zgjeruar shpejt asistencën teknike dhe financiare për të mbështetur këto reforma. Aty ku qeverisja e keqe dhe korrupsioni paraqesin pengesa për zhvillimin dhe angazhimi i qeverisë është jo i njëjlojtë, Banka do të përpiqet të gjejë pikat e duhura të ndërhyrjes—duke zgjeruar mbështetjen për programet e qeverisë për të përmirësuar qeverisjen dhe luftuar korrupsionin, duke siguruar që çështjet e qeverisjes trajtohen siç duhet në sektorët ku Banka angazhohet, dhe duke kërkuar të zgjerojë interesin e qeverisë në reformë nëpërmjet dialogut vendor, punës analitike dhe asistecës teknike. Gama e pikave të ndërhyrjes përfshin:
  - *Ndihma për forcimin e aftësive dhe përgjegjshmërisë së shtetit.* Në të gjithë vendet ku qeverisja është një sfidë, do të ketë një fokus të vazhdueshëm mbi menaxhimin financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve, prokurimeve, auditimit, gjyqësorit dhe reformave ligjore, si dhe një angazhim i rinovuar me qeveritë në lidhje me shërbimin civil dhe reformat e transparencës. Përveç kësaj, do të ketë një vëmendje më madhe sistematike për të adresuar çështjet e qeverisjes në infrastrukturë, industri nxjerrëse, shëndet, arsim, sektorë financiarë dhe private, duke forcuar pushtetin vendor dhe

pjesëmarrjen e komunitetit, dhe duke krijuar kapacitetet në institucionet institucionet e larta të auditimit dhe institucione të tjera zyrtare mbikqyrjeje.

- *Zgjerimi i angazhimit të sektorit privat.* WBG, duke përfshirë IFC dhe MIGA, do të angazhohet më ngushtë me sektorin privat për të adresuar korrupsionin, për shembull duke mbështetur koalicionet kombëtare dhe sektoriale të bizneseve për ndryshime dhe kodet vullnetare të etikës. WBG do të vazhdojë edhe të thellojë mbështetjen e tij për përmirësimin e mjedisit mundësues për zhvillimin e sektorëve privatë dhe financiarë konkurrues dhe investime më të mëdha private.
- *Angazhimi më sistematik me një gamë të gjerë grupesh interesi.* Siç është deklaruar në Komunikatën e Komitetit të Zhvillimit “Qeveritë janë partnerët kyç të Bankës në programet e qeverisjes dhe anti-korrupsionit, ndërsa Banka, brenda mandatit të saj, duhet të jetë e hapur për përfshirje me një gamë të gjerë të institucioneve vendore, duke marrë parasysh specifikën e çdo vendi”. Gjatë punës me qeverinë sipëra e saj kryesore, WBG do të zgjerojë praktikatat e mira ekzistuese në punën me një gamë të gjerë grupesh interesi. Qëllimi është të ndihmojë forcimin e përgjegjshmërisë së shtetit, duke dhënë kështu një shtysë për përfitim në aftësitë shtetërore. Për shembull, siç është konfirmuar nga konsultimet, Banka, në përputhje me mandatin e saj dhe në bashkëpunim me organizata të tjera shumëpalëshe dhe dypalëshe, do të vazhdojë të mbështesë iniciativa që: mundësojnë qytetarët të kenë akses në informacion dhe të marrin pjesë në zhvillimin e politikave, prioritetet e shpenzimeve dhe dhënien e shërbimeve; promovojnë pjesëmarrjen e komunitetit për të përmirësuar qeverisjen vendore; forcojnë mjedisin mundësues dhe kapacitetin e shoqërisë civile dhe mediave për të monitoruar politikë-bërjen publike dhe zbatimin; dhe nxisin një mbikqyrje më të lartë mbi prokurimet publike, deklarimin e pasurive, dhe dimensionet e tjera të rëndësishme të performancës së qeverisjes. Banka do të rishikojë politikën e saj të publikimit për të përmirësuar transparencën e vetë Bankës, dhe do të përmirësojë udhëzimet e tanishme të stafit për të zbatuar në mënyrë të njëtrajtshme praktikatat më të mira mbi konsultimin dhe pjesëmarrjen në operacionet e financuara nga Banka.

17. **Niveli i Projektit.** Në nivel projekti, strategjia e Bankës ka si synim përmirësimin e impaktit të zhvillimit dhe integritetin e projekteve të financuara nga Banka. Veprimet për parandalimin e mundësive për korrupsion—mënyra më e mirë për zbutjen e rreziqeve të përgjegjshmërisë--përfshijnë:

- Ndihma ndaj vendeve për të forcuar sistemet vendore, si zgjidhja afat-gjatë për të zbutur rreziqet e besueshmërisë në operacionet e financuara nga Banka, tek merr masa për të mbrojtur projektet e financuara nga Banka në rrethana të qeverisura keq;
- Përfshirja e objektivave të mira dhe konkrete të qeverisjes dhe antikorrupsionit në programet sektoriale, të adaptuara për veçoritë dhe rreziqet e mundshme të çdo sektori;
- Puna me qeveritë për të identifikuar operacionet e rrezikshme dhe siguruar zbutjen e rrezikut, përfshirë përgatitjen e planeve të antikorrupsionit si pjesë e operacioneve me rrezik të lartë, aty ku është e përshtatshme;

- Përmirësimi i cilësisë së hartimit, supervizimit dhe vlerësimit të projekteve, dhe përmirësimi i monitorimit nga palët e treta të projekteve të financuara nga Banka, duke përmirësuar publikimin në kohë të informacionit mbi projektin (përfshirë planet anti-korrupsion) dhe duke rritur konsultimet dhe pjesëmarrjet gjithëpërfshirëse gjatë gjithë ciklit të projektit, bazuar në mësimet e nxjerra dhe praktikën e mirë;
- Fokusimi mbi shqetësimet e cilësisë së përgjegjshmërisë gjatë analizave të përbashkëta me qeveritë të projekteve dhe portofolit financues të Bankës; kanalizimi i burimeve dhe vëmendjes, veçanërisht gjatë supervizionit, drejt projektve që mendohen të jenë me rrezik të lartë; dhe
- Krijimi i ekipeve anti-korrupsion, veçanërisht në terren, për të rishikuar hartimin e projektit, klasifikimin e riskut, dhe planet e veprimit anti-korrupsion dhe, së bashku me këshilltarët e qeverisjes (veçanërisht ata bazuar në terren), të shërbejnë edhe si një pikë fokale për dialog me qeveritë dhe grupe të tjera interesi mbi çështjet e qeverisjes dhe antikorrupsionit.

Aty ku operacionet bashkë-financohen, Banka do të kordinojë me ata partnerë.

18. Departamenti i Integritetit Institucional (INT) i Bankës, do të vazhdojë të hetojë pretendimet për korrupsion në projektet e financuara nga Banka dhe, kur zbulohet korrupsion, WBG do të ndëshkojë publikisht firmat e korruptuara dhe do të nxitë veprime të mëtejshme nga qeveria dhe ato të brendshme. Përveç kësaj, WBG do të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet ekipit hetimor të Bankës dhe institucioneve anti-korrupsion të vetë vendit. Feedback nga konsultimet ngulmuan që INT të marrë hapa shtesë për të përmirësuar qasjet e tij për transparencën dhe partneritetin. Aktualisht, INT po vlerësohet nga një panel i pavarur ekspertësh, me synimin për të forcuar operacionet dhe efektivitetin e tij.
19. IFC dhe MIGA do të punojnë drejtpërdrejt me sektorin privat për të forcuar praktikën etike korporative në operacionet e tyre, duke i nxitur klientët të bashkohen me koalicionet private-publike për reformë, dhe duke ritheksuar që integriteti është “mirë për biznesin”.
20. *Niveli Global*. Së fundmi, në nivel global, Banka do të mbështesë qasje të harmonizuara me aktorë të tjerë ndërkombëtarë. Strategjia ka për synim forcimin e partneriteteve dypalëshe dhe shumëpalëshe të WBG në përputhje me Deklaratën e Parisit, me një pikëpamje për:
  - Harmonizimin e iniciativave të qeverisjes dhe anti-korrupsionit me IMF, Kombet e Bashkuara, bankat rajonale të zhvillimit dhe donatorë të tjerë, duke përfshirë menaxhimin financiar publik, prokurimet dhe reformën në gjyqësor;
  - Promovimi i veprimit të kordinuar në vendet ku problemet e qeverisjes dhe anti-korrupsionit përbëjnë sfida për zhvillimin, përfshirë konsultimin me partnerë të tjerë, në rastet kur merret parasysh një angazhim të kufizuar;
  - Duke pranuar kufizimet e kuadrit ligjor të Bankës, duhet të ketë një ndarje punë ndërmjet donatorëve—për tu shtjelluar në CAS—ku të tjerët të udhëheqin në fusha që janë jashtë mandatit ose përparësive krahasuese të Bankës;

- Vazhdimi i punës në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat, shoqërinë civile, rininë dhe median për të mbështetur koalicionet e ndryshimit siç është Aleanca Globale për Integritetin, si dhe iniciativa specifike sektoriale siç është Iniciativa e Transparencës së Industrisë Nxjerrëse (EITI) dhe Publiko se Çfarë Pague, duke ngritur paralelisht koston e sjelljes së korruptuar nëpërmjet sanksioneve gjithnjë e më të harminzuara të MDB dhe Programit të ri të Publikimit Vullnetar të WBG;
- Mbështetja e zbatimit të konventave ndërkombëtare kyç siç janë Konventa Kundër Mitëmarrjes e OECD, Konventa kundër Korrupsionit e OKB, dhe iniciativat rajonale;
- Ndihma për të përmirësuar aftësitë e një vendi për të zbuluar, ngrirë dhe konfiskuar të ardhurat nga sjelljet e korruptuara, duke përfshirë asistencën teknike për rekuperimin e asetëve dhe monitorimin e përdorimit të asetëve të rekuperuara; dhe
- Duke punuar me vendet e zhvilluara, OECD , dhe sektori privat të japin asistencë kunder pastrimit të parave, dhe bashkëpunim më të madh për të trajtuar strehët e taksave dhe kthimin e asetëve.

21. **Monitorimi për Rezultate.** Monitorimi është çelësi për llogaridhënien. Duke njohur që burimet e IDA do të vazhdojnë të alokohen nëpërmjet Vlerësimit të Politikave dhe Insitucional të Vendit (CPIA) dhe sistemit të Alokimit me Bazë Performancën, Komiteti i Zhvillimit i kërkoi Bankës të zhvillojë më tej dhe të përdorë indikatorë specifikë dhe të veprueshëm. Këto indikatorë mundë të shërbejnë për dy qëllime—të informojnë CPIA dhe të ndihmojnë gjurmimin e progresit në reforma specifike të zbatuara nga qeveritë. Gjatë vitit të kaluar është bërë progress i rëndësishëm në zhvillimin dhe përdorimin e indikatorëve specifikë dhe të veprueshëm, siç janë indikatorët e menaxhimit financiar publik të zhvilluar nga iniciativa e Përgjegjshmërisë së Shpënzimeve dhe Financiar Publik (PEFA). Indikatorët e bashkuar të qeverisjes (të mbledhur nga DEC dhe WBI) janë produkte kërkimi që mbështeten në një informacion të pasur nga përpjekje jo-WBG për të monitoruar qeverisjen dhe ekzistojnë paralelisht me shumë produkte të tjera (p.sh. studimet e ndërmarrjeve), për të dhënë informacion krahasues për politikë-bërësit; ato nuk janë renditje zyrtare nga WBG, dhe ato nuk kanë një rol formal në ndonjë vendim-marrje operative të WBG. Gjatë konsultimeve të fundit, shumica e grupeve të interesit mbështetën një qasje të përdorimit të një përzierje indikatorësh—indikatorë të bashkuar të qeverisjes, sistemet vendore të monitorimit dhe vlerësimit, indikatorë specifikë të ndarë, dhe indikatorë rezultatesh—me mature dhe kujdes, duke mbajtur parasysh pikat e forta dhe kufizimet për qëllime të veçanta.

22. **Roli i Bordit.** Bordi i Bankës do të vazhdojë të ketë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e strategjive të Bankës për vendet, për të siguruar që ato janë të njëtrajtshëm në gjithë vendet dhe për të vazhduar të kenë një mbështetje të gjerë në bashkësinë ndërkombëtare. Nëse ndryshojnë rrethanat në atë mënyrë që garantojnë një zhvendosje në qasjen e Bankës, do të paraqitet një dokument për tu diskutuar në Bord. Përveç kësaj, për të gjithë CAS që paraqesin skenare alternative, CAS dhe Raporti i Progresit afat-mesëm i CAS do të vazhdojnë të deklarojnë qartësisht se cili skenar funksionon si dhe cilat kushte mund të vinin në punë skenaret alternative. Zhvillimet e reja të vendeve do të vazhdojnë të diskutohen në takimet e Komitetit Drejtues, dhe këndvështrimet e Drejtuesve mbi nivelet e përshtatshme të financimit do t'i paraqiten Bordit në kohë. Në rastet e jashtëzakonshme kur ndryshimet në rrethanat e vendit kërkojnë një ndryshim të rëndësishëm apo një pezullim të operacioneve të Bankës, Drejtuesit

do të kërkojnë mbështetjen e Bordit. Bordi do të vazhdojë të përfshihet në rishikimin e projekteve të veçantë, përfshirë dhe ato që janë vonuar për shkak të problemeve të korrupsionit. Gjithashtu, Bordi ka dhënë udhëzime dhe feedback mbi përpunimin e kësaj strategjie dhe do të bëjë mbikqyrjen gjatë zbatimit.

23. **Rruga Përpara.** Kjo strategji nënkupton një ndryshim në mënyrën e punës së WBG, duke përfshirë dhënien e stimujve menaxherëve dhe stafit për tu angazhuar aktivisht në terren rreth çështjeve të qeverisjes; duke adresuar nevojat për staf, aftësi dhe burime për të funksionuar efektivisht në sfidën ndaj kontekstit të qeverisjes; dhe duke zhvilluar një kuadër më të fuqishëm rezultatesh, me progress më të madh në forcimin e sistemeve vendore të monitorimit dhe vlerësimit, indikatorët e ndarë specifikë të qeverisjes, dhe indikatorët e rezultateve. Theksi i strategjisë do të jetë në vijën e parë, duke u angazhuar ngushtësisht me vendet partnere. Do të hartohen udhëzime operative për stafin, duke reflektuar inovacionet aktuale në terren. Ekipet vendore të Bankës do të raportojnë grupeve të interesit që morën pjesë në konsultime, për të ndarë me ta mënyrën se si inputet e tyre janë pasqyruar në këtë strategji të përmirësuar dhe për t'i angazhuar ata në fazën e zbatimit. Duke parë kompleksitetin e përpjekjes, WBG do të duhet të veprojë në mënyrë pragmatike. Gjithashtu, do të ketë nevojë të forcohen partneritetet, përfshira ato me institucionet vendore si universitetet, grupet e shoqërisë civile, dhe biznese për të rritur njohuritë teknike të Bankës dhe zhvilluar qasje të përbashkëta. Për më tepër, për shkak të rëndësisë së mësimin në këto fusha, Banka do të vazhdojë të mbështesë kërkimet mbi shkaqet dhe pasojat e qeverisjes dhe korrupsionit dhe lidhjet e tyre me rritjen dhe zhvillimin. Kjo axhendë kërkon inovacion dhe eksperimentin si dhe monitorim dhe vlerësim rigoroz të rezultateve—gjithshka në një frumë hapjeje për të mësuar se çfarë funksionon, çfarë jo, dhe përse. Iniciativat specifike që nevojiten për të vënë në funksionim të plotë këtë strategji do të përshkruhen në një Plan Zbatimi, për tu përgatitur dhe dorëzuar në Bord deri në fund të vitin fiskal aktual.